



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Poliçan

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Tiranë, dhjetor 2024

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PËRMLLEDHJE EKZEKUTIVE	2-5
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	2-5
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II.	HYRJA	6-12
1	Objektivat dhe qëllimi	7-7
2	Identifikimi i çështjes	7-7
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
5	Kriteret e Vlerësimit	9-10
6	Standartet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	12-65
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-12
1.	Përshkrimi i auditimit sipas drejttimeve të auditimit	12-65
1.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2023	12-20
2.1	Burimi i krijimit të ardhurave dhe mbledhja e tyre	20-39
3.1	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023	39-54
4.1	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike Aseteve dhe Pyje Kullotavetë transferuara sipas VKM.	54-62
IV.	REKOMANDIME	62-71

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Poliçan, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Poliçan për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

- Për vitin 2023 Bashkia Poliçan nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej vlerën 135,774 mijë lekë.

-Për vitin 20223 nga Bashkia Poliçan janë shpenzuar gjithësej 952,510 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 163,810 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 66,455 mijë lekë; për transfertat koherente të brendshme 1,670 mijë lekë; për ndihma ekonomike invaliditeti në vlerën 97,748 mijë lekë; për investime në vlerën 62,2827 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Poliçan për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

- Auditim mbi Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.

- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

-Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike. (Aseteve dhe pyje kullota) të transferuara sipas VKM.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 5,436 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Poliçan për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 19 gjetje dhe janë lënë 19 rekomandime.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Poliçan lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik/familjarë, ku në fund të vitit 2022 rezultojnë debitorë në vlerën 74,697,760 lekë, ndërsa detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 është në vlerën 5,819,971 lekë. Në fund të vitit 2023 mbetet vlera debitorë progresive është 80,517,731 lekë. Pjesa me e madhe e detyrimit ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të detyrimit nga subjekti “*Kombinati Mekanik Poliçan*” subjekt i cili është debitorë për vlerën 20,163,230 lekë ose në masën 67 % ndaj totalit të detyrimit nga subjektet “*Fizik /Juridik*” dhe 25 % të totalit të debitorëve deri me 31.12.2023. Detyrimi tatimor në Bashkinë Poliçan më 31.12.2023 është në vlerën 80,517,731 lekë, vlerë kjo e kontabilizuar, cila përbëhet konkretisht nga:

- Debitorë Biznesi në vlerën 29,916,189 lekë për 85 subjekte.

- Debitorë për taksa dhe tarifa vendore për abonentët familjarë në vlerën 3,153,019 lekë për 952 abonentë.

- Debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 47,448,523 lekë për 2357 subjekte.

- Nga auditimi i Llogarisë 466 “*Kreditore për mjete nën ruajtje*”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 42,935,296 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 24 objekte. Nga këto objekte, për 14 prej tyre vlera e ngurtësuar e garancisë së punimeve në vlerën 1,732,975 lekë dhe pse afati i garancisë ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për xhirimin e fondeve te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

- Në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1623 pasuri të transferuar në pronësi të miratuar me VKM, nga këto të pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan janë vetëm 53 pasuri, ndërsa për 1570 pasuri nuk është aplikuar. Bashkia Poliçan nuk ka përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK.

- Në 1 rast, nga Drejtoria e Tatim-Taksave nuk është përlllogaritur kamatë vonesa prej 2 ditësh, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” shpk, duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën prej 211,200 lekë, në kundërshtim me nenin 5.2. të kontratës së qirasë “Pagesa e Qirasë”.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave vendore të marri masat përkatëse duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të taksave në vlerën 80,517,731 lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

- Drejtoria e Tatim-Taksave të njoftojë qiramarrësin shoqërinë “X” shpk i përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, për likuidimin e shumën prej 211,200 lekë, shuma e cila ka lidhje me mos përlllogaritjen e kamatë vonesës prej 0,01 % në ditë, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” shpk.

-Bashkia Poliçan të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar) për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohen në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2023:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Poliçan për periudhën ushtrimore 01.01.2023–31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar me theksim të çështjes:

"Në gjykimin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Poliçan janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të “modifikuar me theksim të çështjes”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksim të çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 6,583 mijë lekë, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si më poshtë:

-Nga grupi i auditimit u konstatua se nuk ka analiza për llogarinë nr.202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 2,704,895 lekë. Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përbëhet nga vlera e garancisë së punimeve prej 5% e vlerës së kontratës për 24 objekte. Për 14 prej këtyre objekteve vlera e ngurtësuar e garancisë është 1,732,975 lekë dhe afati i garancisë sipas kontratës, edhe pse ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për transferimin e fondeve te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar.

- Llogaria 218 “inventar ekonomik”, nga shqyrtimi i analizës së kësaj llogarije rezulton se: është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 5,742,796 lekë duke e mbivlerësuar këtë llogari për 19 aktive, të cilat sipas klasifikimit kontabël 17 prej tyre i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 2 (dy) aktive i përkasin llogarisë nr.212 “Ndërtime konstruksione”.

-Në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 896, datë 11.6.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisë Vendore, Bashkisë Poliçan, Qarkut Berat". Sipas këtij vendimi Bashkia Poliçan ka në pronësi gjithsej 161,000 m² nga të cilat 135,000 m² pyll prodhues (gështenja), 26,000 m² pyll (pishë e egër). Veprimi është në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi I, pika 2 klasa 2.

-Nga 1623 pasuri që janë ë juridiksionin e Bashkinë Poliçan të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM, janë regjistruar në regjistrat kadastral (DV ASHK Berat dhe Skrapar) dhe pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan vetëm 53 pasuri, ndërsa 1570 pasuri vijnë të pa regjistruar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH.”

-Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 9.93 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Poliçan në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 896/1 prot., datë 04.07.2024 “Auditim financiar

në Bashkinë Poliçan”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04.07.2024 – 02.08.2024, në subjektin Bashkia Poliçan për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “*Auditim Financiar*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S.D, Përgjegjës grupi;
2. R.L, Auditues;
3. S.S, Auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përparatë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projektaporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Poliçan.

2. Identifikimi i çështjes

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të riskut, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëseve të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Poliçan, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Poliçan.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë Poliçan (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Poliçan, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Poliçan në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Poliçan është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet

ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve*”.

e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përrputshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përrputshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminonj përrputhjen ndërmjet

regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rregullore e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit miratuar me vendim të kryetarit të KLSH-së nr 197 prot., datë 12.10.2022. Rregullore e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit miratuar me vendim nr.07, datë 17.01.2024.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 5 aktkonstatime. Gjatë hartimit të Projektraportit, sipas përcaktimeve ligjore nuk janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Bashkia Poliçan, përcaktuar me shkresën me nr.1550/9 prot datë 27.08.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 896/3 prot datë 29.08.2024. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Poliçani kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Berat, në lindje me Bashkinë Skrapar, ndërsa në jug dhe jug-lindje me Bashkinë Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Poliçanit. Sipas Censurit të vitit 2023 Bashkia Poliçan numëron 8 762 banorë., Bashkia ka një sipërfaqe prej 272.02 km² me një densitet prej 67.42 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative të cilat kanë në total 26 fshatra. Bashkia e Poliçanit përbëhet nga Njësia Administrative Poliçan, qyteza ish-industriale e Poliçanit dhe dy njësitë administrative Vërtop dhe Terpan. Nga këto, Njësia Tërpan, shtrihet në një terren të thyer malor. Qyteti i Poliçanit ka qenë një qendër e rëndësishme e industrisë ushtarake dhe e industrisë së materialeve të ndërtimit për shkak të burimeve të mëdha të gurit. Industria e nxjerrjes së gurit dekorativ është në ditët e sotme një resurs i konsiderueshëm ekonomik për zonën. Poliçani ka në territorin e tij një pjesë të konsiderueshme të parkut kombëtar të Tomorit. Për rrjedhojë, turizmi malor është një element i rëndësishëm i bashkisë. Të ardhurat në zonat rurale vijnë kryesisht nga kultivimi i ullirit dhe rrushit, por edhe drurëve të tjerë frutorë si gështenjat, arrat dhe fiqtë.

1. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve

1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e rregjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre.

1.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e Linjës etj.).

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
4. Akt Rakordimi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve;
6. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
7. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.
8. Dokumentacion të bankës etj.

Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- Kryetari i Bashkisë nuk ka përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;;

-Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2022.

-Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve.

- Nuk janë përgatitur kërkesat buxhetore referuar nevojave dhe objektivave të Bashkisë Poliçan.

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Buxheti i 2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak brenda afateve si dhe është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat, konkretisht:

Për vitin 2023, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 53 datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023” brenda afatit ligjor, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 01 Prot. datë 11.01.2023.

Planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2023 paraqitet në tabelat në vijim:

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	86,483	Art. 600 Paga	139,115
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	6,028	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	24,854
Total të ardhurat e veta	92,511	Art.602 Shpenzime operative	82,294
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	5,462	Art.604 Transferime korrente te brendshme	700
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	4,759	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,248
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	145,918	Art.230-231 Investime	69,794
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2023	72,355	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	0
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	228,494		0
TOTALI TE ARDHURAVE	321,005	TOTALI SHPENZIMEVE	321,005

Burimi: Bashkia Poliçan

Rezultoni se buxheti për vitin 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 321,005 mijë lekë

Planifikimi i të ardhurave përbëhet, nga totali i të ardhurave të veta në vlerën 92,511 mijë lekë dhe totali të ardhurave nga transfertat e buxhetit të shtetit në vlerën 228,494 mijë lekë.

Në lidhje me planifikimin e shpenzimeve për vitin 2023 planifikimin më të madh e zë artikulli 600 shpenzime për paga në vlerën 139,115 mijë lekë.

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njesisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit

duke u bazuar në faktin e vitit parardhës. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Skrapar dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Poliçan ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Berat. Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten si më poshtë:

-Ndryshimet miratuar me VKB nr.14 datë 25.07.2023,për shpërndarjen e fondit të akorduar për rritjen e pagave në zbatim të VKB. nr .328,datë 31.05.2023.

-Ndryshimet miratuar me VKB nr. 21 prot., , datë 25.08.2023, për ndryshimin e buxhetin të vitit 2023.

-Ndryshimet miratuar me VKB nr. 29 prot., datë 31.10.2023, “për shpërndarjen e tranfertës së pakushtëzuar.”

- Ndryshimet miratuar me VKB nr 20 prot., datë 25.08.2023, “ për dhënien e ndihmës ekonomike”.

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 53 , datë 23.12.2022	Buxheti shtesë, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1		1+2		3		3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	51,700	34,784	86,483	Art. 600 Paga	114,516	24,599	139,115
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2023	0	6,028	6,028	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	20,280	4,574	24,854
Total të ardhurat e veta	51,700	40,812	92,511	Art. 602 Shpenzime operative	61,657	20,637	82,294
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	0	5,462	5,462	Art.604 Transferime korrente të brendshme	700	0	700
Të ardhura të trashëguara nga transferta specifike	0	4,759	4,759	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	3,334	914	4,248

Transferta e pa kushëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	117,328	28,590	145,918	Art. 230-231 Investime	38,160	31,634	69,794
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	69,619	2,735	72,355	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	0	0	0
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	186,947	41,546	214,273		0	0	0
TOTALITE ARDHURAVE	238,647	82,358	321,005	TOTALI SHPENZIMEVE	238,647	82,358	321,005

Burimi: Bashkia Poliçan

1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Skrapar, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Skrapar, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Poliçan, për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta+grante	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
1	Artikulli - 600 Paga	143,698	139,871	97.3	135,343	4,527
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	25,266	23,939	94.7	235,50	389
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	73,075	66,455	90.9	65,973	483
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	2,370	1,670	70.5	0	1,670
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	101,969	97,748	95.9	2,566	95,182
6	Artikulli - 230 Projekte	7,353	0	0	0	0
7	Artikulli - 231 Investime	637,255	62,2827	97.7	44,513	578,314
	TOTAL VITI 2023	990,986	952,510	96.1	271,945	680,565

Burimi: Bashkia Poliçan

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 96.1%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 231 “Kapitale të Kapitale të Trupëzuara”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë Transfertat Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2023 art. (604) transferta korente të brendshme paraqiten 70.5 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët. Përsa i përket vlerës së mbuluar nga të ardhurat e veta + Granti është 71,945 mijë lekë ose në masën 28.5 %, dhe Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti është 680,565 lekë ose në masën 71 %.

Për të arritur një konkluzion më poshtë, është i pasqyruar buxheti sipas burimeve të financimit:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt.											
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit te realizuar						
					Nga Granti Qeveritar						
					Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga transferata e pakushtëzuar	Nga transferata e kushtëzuar specifike	Nga Sponsorizimet	Nga transferata e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transferata e kushtëzuar për investimet
1	Paga 600	143,698	139,871	97.3	23,149	16.1	54,077	58,118	0	4,527	0
2	Sigurime shoqërore 601	25,266	23,939	94.7	4,755	18.8	8,573	10,222	0	389	0
3	Shp. Operat 602	73,075	66,455	90.9	22,046	30.2	38,556	5,370	0	483	0
4	Subvencion 603	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Transferata Korrente te brendshme 604	2,370	1,670	70.5	0	0	0	0	0	1,670	0
6	Transferata per familje dhe individe 606	101,969	97,748	95.9	350	0.3	2,111	105	0	95,182	0
7	Investime 230-231	644,608	622,827	96.6	13,883	2.2	29,852	0	778	0	578,314
	Totali	990,986	952,510	96.1	64,183	6.6	133,169	73,815	778	102,251	578,314

Burimi: Bashkia Poliçan

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferata e kushtëzuar për investimet, në vlerën 578,314 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Poliçan, ndjekur nga transferata e pakushtëzuar për në vlerën 133,169 mijë lekë, nga transferata e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 102,251 mijë lekë, nga të ardhurat e veta në vlerën 64,183 mijë lekë. Buxheti nga transferata e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 102,251 mijë lekë, ose 10.7 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës Kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transferata për familje dhe individ, paga dhe fonde të shpenzuara për transferime korrente të brendshme. Nga transferata e kushtëzuar për investime për vitin 2023 është realizuar në vlerën 578,314 mijë lekë, ose 60.7 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për investime, e zënë shpenzimet për investime. Buxheti nga transferata e pakushtëzuar për vitin 2023 është realizuar në vlerën 133,169 mijë lekë, ose 13.9 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative. Buxheti nga të ardhurat e veta (taksat dhe tarifat vendore) për vitin 2023 është realizuar në vlerën 64,183 mijë lekë, ose 6.6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative. Përsa i përket Realizimit të Investimeve nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur Sektori i Finances dhe Buxhetit konstatohet se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në vitin 2023, në masën 97.7 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ku vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta është në vlerën 64,183 mijë lekë ose 6.6% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, që do të thotë se nga Bashkia Poliçan në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura për investime , duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Konkretisht për Kapitale të Patrëpëzuara/Kapitale të Trupëzuara janë planifikuar në vlerën 96,230 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 92,150 mijë lekë. Këto veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

Fondi i emergjencës është përdorur sipas VKB-ve pasqyruar në tabelën më poshtë:

Kryesisht ky fond është përdorur për akordimin e ndihmave financiare, për ndihma emrgjente, për ndërtimin e banesave të dëmtuara. Pra përdorimi i këtij fondi ka patur si fokus dhe është përdorur për familjet në nevojë. Ky fond është përdorur në vlerën 1,898,000 lekë.

Përkatësisht me VKB nr. 26 datë 20.09.2023 ndihmën financiare në 3 raste për vlerën e mbetur 724,398 lekë sipas preventivit të hartuar nga komisioni i ekspertëve të këshilli i qarkut, nga , fondi emergjencës, granti i pa kushtëzuar 00 programi 04980 kapitulli 01, artikulli.606 akorduar për bashkinë Poliçan.

VKB-të e përdorura të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Nr	Vendimi I Keshillit të Bashkise		Konfirmim nga Prefektura e Berat		Vlera
	Nr	Date	Nr	Date	
1	7	23.01.2023	186/1	24.01.2023	105.000
2	17	29.03.2023	242/1	06.4.2024	200.000
3	24	24.04.2023	299/1	25.04.2023	500.000
4	26	27.04.2023	306/1	03.05.2023	206.500
5	26	20.09.2023	694/1	25.09.2023	253.872
6	26	20.09.2023	694/1	25.09.2023	264.020
7	31	31.10.2023	775/1	01.11.2023	368.608
	Totali				1.898.000

Burimi: Bashkia Poliçan

Raportet e Monitorimit

Për vitin 2023 Bashkia Poliçan me shkresën nr. 1419 , datë 24.05.2023, ka përcjellë në MFE Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për 4 mujorin e parë.

Për 4/mujorin i dytë për vitin 2023 është dërguar në MF me shkresën nr. 2511 prot, datë 26.09.2023.

Për 4/mujori i tretë 2023 dërguar në MF me shkresën nr. 283 , datë 31.01.2023.

Raportet e monitorimit përgjithësisht është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë paraqitur për diskutime edhe në Këshillin Bashkiak.

1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, celja e fondeve dhe realizimi i tyre.

Bashkia Poliçan në përputhje me VKM, Nr 285, datë 15.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 3, ka hartuar rregjistrimin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. Në auditimin e kryer në Bashkinë Poliçan referuar rregjistrin të parashikimit për procedurat të cilat do të parashikohen të kryhen gjatë vitit 2023 për blerje mallra, shërbime dhe investime janë parashikuar 50 procedura prokurorimi me fond limit 230,557,068 lekë pa tvsh këto pa përfshirë procedurat me blerje nën 100,000 lekë. Referuar rregjistrin të realizimit janë zhvilluar 40 procedura prokurimi me fond limit 217,358,076 lekë pa tvsh në këtë vlerë nuk janë përfshirë procedurat me vlerje nën 100,000 lekë. Referuar rregjistrin të realizimit, Bashkia Poliçan nuk ka zhvilluar 6 procedura prokurimi të cilat janë parashikuar të zhvilloheshin në vitin 2023 referuar VKB Nr.53, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit. Procedurat e parashikuar në regjistrin e parashikimeve publike 2023 të cilat nuk janë realizuar nga AK Bashkia Poliçan si më poshtë:

1. “Shpenzime për blerje uniformash dhe pajisje speciale për sektorin e MZSH-SE” me fond limit në vlerën 183,333 lekë pa tvsh. Fondi limit 183,333 lekë pa tvsh është planifikuar nese do te kishte shtesë të numrit total të personelit ne kete strukture. Në këtë strukture ka patur ndryshime por jo shtese të numrit tëpersonelit.

2. “Mirëmbajtje e kanaleve ujites dhe kullues”, me fond limit ne vlerën 1,000,000 pa tvsh.

Kjo procedurë nuk është realizuar pasi bashkia Poliçan është financuar nga AKMC ne vlerën 57 567,958 për realizimin e prokurimit publik me objekt: Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum , fshati Mbrakull, Polican.

3. “Shërbim ekspertimi”, me fond limit në vlerën 333,333 leke pa tvsh. Autoritetit kontraktor nuk i ka lindur nevoja per shërbime ekspertimi gjatë vitit kalendarik 2023.

4. “Shpenzime per hartimin e projekteve të ndryshme” me fond limit në vlerën 583,333 lekë pa tvsh. Autoritetit kontraktor i ka lindur nevoja per një vlerë më të lartë të fondit limit për realizimi e hartimit të projekteve të domosdoshme për vitin kalendarik 2023. Për kete arsye ka realizuar porceduren e prokurimit me objekt: Studim Projektim i Projekteve për Investim të Bashkisë Piliçan me fond limit në vlerën 16,666,666 lekë pa tvsh .

5. “Shpenzime per furnizim dhe vendosje kamera” me fond limit në vlerën 1,000,000 pa tvsh. Autoritetit kontraktor i ka lindur nevoja për një vlerë me të lartë të fondit limit per furnizim dhe vendosje kamerash . Për këtë arsye ka realizuar porcedurën e prokurimit me objekt: Shpenzime per blerje dhe vendeje kamerash ne hyrje te qytetit dhe ne objektet arsimore me fond limit ne vlerën 1,666,666 lekë pa tvsh .

6. “Blerje sobash me dru zjarri për shkollat dhe kopshtet” me fond limit ne vlerën 166,666 lekë pa tvsh. Parashikimi është bërë për blerje sobash për shkollën 70 ‘Vjetori i Pavarsisë’ shkollë e cila është ende në rikonstruksion dhe do të funksionojë me sistemin ngrohës të kaldajës. Referuar situatës më lart ku ka mangësi të theksuara në parashikimin e procedurave të prokurimit. Regjistri i parashikimeve dhe i realizimeve të procedurave të prokurimeve Bashkëlidhur në aneksin B1 dhe B2 ne “Kapitullin Aneksë”

1.5.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2023.

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022 (në lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 (në lekë)	Total detyrime (në lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023 (në lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 (në lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	21,813,205	0	21,813,205	8,394,485	13,418,720
Vendime gjyqësore	7,082,391	0	7,082,391	2,652,382	4,430,009
Mallra dhe shërbime	1,389,193	5,860,088	7,249,281	6,732,104	517,177
Energji elektrike	1,298,980	0	1,298,980	578,580	720,400
Shpronësime	6,451,432	0	6,451,432	760,315	5,691,117
Transferta tek subjektet	2,220,000	0	2,220,000	0	2,220,000
Totali	40,255,202	5,860,090	46,115,289	19,117,870	26,997,423

Burimi: Bashkia Poliçan

Bashkia Poliçan në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 40,255,202 lekë . Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2023 vlera 14,842,101 lekë. Gjatë vitit 2023 për detyrimet e prapambetura është likuiduar vlera 19,117,870 lekë. Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 5,860,090 lekë, totali progresiv i detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat dhe granti janë në vlerën 26,997,423 lekë. Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura nga të ardhurat e veta Bashkia Poliçan ka marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet

kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Poliçan.

Vlera e raportuar nga Bashkia Poliçan në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është 26,997,423 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 283 prot., datë 30.01.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
b	Hua afatshkurtër	0		
II	Detyrime (a+b+c)	26,997,423		9.93%
a	Shpenzime korrente	9,148,694		
a.1	Mallra dhe shërbime	1,237,577		
a.2	Paga dhe sigurime	0		
a.3	Të tjera	7,911,117		
b	Shpenzime kapitale	13,418,720		
b.1	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	4,430,009		
c.1	Marrëdhënie pune			
c.2	Mallra dhe Shërbime			
	Totali (I+II)	26,997,423	271,945,512	9.93 %

Burimi: Bashkia Poliçan

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 9.93 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Poliçan në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Bashkia Poliçan ka patur Detyrime për vendime gjyqësore në fillim të vitit të mbartura nga viti 2022 në vlerën 7,082,391 lekë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 2,652,382 lekë, vlerë e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim si objekt i vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 është në vlerën 4,430,009 lekë. Vlera totale **2,652,382 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga Bashkia Poliçan, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, *konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet*. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ku do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Përmbledhëse e faturave te pa likujduara brenda afatit 30 ditor për vitin 2023.

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Skrapar, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2023, ky afat nuk është respektuar në 5 raste për vlerën 5,860,088 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë:

Përmbledhëse e faturave për vitin 2023

Emërtimi i detyrimit / fatura / Shërbime Ilog 4864200	Vlera
1.Shërb. i pastr. gjelb. Dek Fat nr.14/2022 , date 01.11.2022 Cotoni Center	1,001,228
2.Shërb. i pastr. gjelb. Dek Fat nr.15/2022 , date 05.12.2022 Cotoni Center	1,446,016
3.Shërb. i pastr. gjelb. Dek Fat nr. 4/2023, date 03/4/2023 Cotoni Center	1,680,140
4.Shërb. i pastr. gjelb. Dek Fat nr. 8/2023 , date 06/7/2023 2 Cotoni Center	1,376,728
5.Shërb. i pastr. gjelb. Dek Fat nr. 7/2023 , date 07/6/2023 Cotoni Center	355,976
Totali	5,860,088

Burimi: *Bashkia Poliçan, përpunuar nga grupi i auditimit.*

Nga 5 (pesë) fatura me vlerë totale 5,860,088 lekë, janë likujduar brenda vitit 2023 nga të ardhurat e veta vlera 2,254,455 lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar vlera 3,605,635 lekë. Faturat e cituara si më lartë kanë patur si objekt shërbimin për pastrimin, gjelbërimin, dekorin dhe mirëmbajtje varreza. Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash. Këto veprime janë në kundërshtim me Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, mbajnë përgjegjësi: *Kryetari i Bashkisë z. A.Z në cilësinë e nëpunësit autorizues, zj. F.H Drejtor i Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

2.Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.

2.1. Planifikimi dhe realizimi i tyre.

2.2. Mënyra e llogaritja dhe vlerësimi i të ardhurave sipas zërave (taksa/tarifa), në zbatim të paketës fiskale sipas programit të auditimit.

2.3. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.4. Evidentimi i debitorëve progresivë dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

2.5. Auditimi i procedurave të dhënies me qira të pronës publike dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023

-Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.

-Regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

-Rakordimet me agjentët tatimor.

-Evidenca e planifikimit të të ardhurave.

-Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.

-Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.

-Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i i Tatim Taksave , në lidhje me çështjen e të ardhurave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Organizimi i Strukturës së Taksave

Për vitin 2023, pranë Bashkisë Poliçan është krijuar dhe ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore me përbërje Sektorin e Taksave dhe Sektorin e Shërbimit të Transportit. Sektori i taksave në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, si dhe me inspektorët e taksave, për çdo Njësi Administrative, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtim/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara. Ky sektor për vitin 2023 ka patur 5 punonjës në organikë. *Numri i voge i punonjësëve ka ndikuar në mbledhjen e Taksave Vendore. Organizimi i strukturës së taksave bashkëlidhur në aneksin A1 në “Kapitullin Anekse”.*

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Poliçan është miratuar me VKB-në nr. 54, datë 23.12.2022 “Mbi caktimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti me shkresën nr. 3047 prot., datë 28.12.2022. Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Poliçan për vitin 2023 janë realizuar në masën 63.6 %, nga 86,482,673 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 135,774,546 lekë. pra realizimi është mbi planifikimin e bërë. Nga auditimi konstatohet se, për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore rezulton se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Konkretisht Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është planifikuar në vlerën 2,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 1,696,605 ose në masën 84.8 %, Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është planifikuar në vlerën 867,3000 lekë dhe është realizuar në 427,8144 lekë ose në masën 49.3 %, taksa e tabelës është planifikuar në vlerën 19,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 18,600 lekë ose në masën 98 %, nga tarifa veterinare të bagëtive të therura është planifikuar në vlerën 384,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 53,000 lekë ose në masën 13.8 %. Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme. Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave. Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Poliçan që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiqit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm

të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave sipas llojeve

Nr	Emërtimi	Viti 2023		%
		Plan	Fakt	
I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE			
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biz. e vogël	100,000	0	
2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	18,489,000	8,261,846	44.6
5	Taksa e ndikimit në infr. nga ndërtime e reja	2,000,000	1,696,605.8	84.8
7	Takse Tabele	19,000	18,600	98
10	Takse Reklame	95,000	54,125	56.9
II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA			
1	Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4,000,000	4,826,355	56.9
2	Taksa pronësisë për pasuritë e paluajtshme			
3	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,500,000	4,334,546	34.6
4	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	0	17,249	
III	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE			
1	Te ardhur nga tarifa e pastrimit të mbeturinave	10,904,000	10,273,951	94
2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	455,000	462,093	98.4
3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	455,000	463,103	98.2
4	Të ardh. tarifa të shërbimit të bashkisë			
a	Nga tarifa veterinerë të bagëtive të therura	384,000	53,000	13.8
b	Nga Tarifat e liçensimit të transportit	200,000	1,8019	
c	Nga tarifa parkimi.	249000	140075	56
d	Nga tarifë dhënie liçensa për tregtimin e naftës.	0	1200000	
e	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	400000	807500	49
f	Nga tarifat e shërbimeve që kryen e MNZ	30000	60000	49.5
g	Nga tarifa për zënie e hapësirave publike	350000	736465	47.5
i	Tarifa nga kopshtet			
j	Tarifa nga cerdhet	250000	300330	83.2
IV	TË ARDHURA TË TJERA			
1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative	50000	8000	16
2	Të ardhura nga dhënie me qira e aseteve.	23,347,600	83,648,335	27.9
3	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	0	439984	
6	Të ardhura të tjera	13,832,073	13,436,138	97
V	TË ARDHURA NGA DONACIONET			
1	Gjoha Gjendje Civile			
2	Sponsorizime	700,000	240,082	3.42
	Totali	86,482,673	135,774,546	63.6

Burimi Bashkia Poliçan

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen regjistrim manual të çdo informacioni që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Poliçan dhe i administron në programin “Excel”, në mungesë të një sistemi elektronik të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Nga ana e Sektorit të Tatim-Taksave, të dhënat janë në regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi elektronik të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave, duke rrezikuar të ketë gabime

në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave dhe editime të tabelave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin “Excel” paraqet një risk të lartë me pasojë humbjen e të dhënave të tatimpaguesve dhe/ose përlllogaritje të gabuara të detyrimeve, penalteteve dhe kamatëvonesave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7 Situata e lëvizjes së subjeteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Poliçan bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023.

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja	Regjistrime	Mbyllur	Gjendja në fund të periudhës 2023
			Në fillim	Reja	Aktiviteti	
1	Biznes i vogël	2023	153	2	5	150
2	Biznes i madh	2023	25	0	0	25
3	Institucione	2023	11	0	0	11
	TOTAL		189	2	5	186

Burimi : Bashkia Poliçan.

Mbi Agjentët Tatimor.

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Poliçan (*brenda datës 5 të çdo muaji*)

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Berat në lidhje me numrin e mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore, sa nga këto mjete janë aktiv në gjendje pune, sa nuk janë në gjendje pune, sa paguajnë dhe sa nuk paguajnë dhe nëse derdhet në buxhet bëhen sipas afateve ose jo. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Poliçan, paraqiten si vijon:

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Poliçan.

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2023
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	4,826,355
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	0
DPT & DPD	Renta Minerare	17,249
TOTALI		4,843,604

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi. Bashkia Poliçan nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Për sa më sipër, Bashkia Poliçan nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Poliçan, nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj gjithashtu nuk ka filluar procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Këto veprime janë në kundërshtim me Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Menaxhimi i borxhit

Subjektet Debitore.

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik paraqitet si më poshtë:

Nr.	Natyra E Debitoreve	Debitor Deri Me 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakesime 2023	Debitore Deri Me 31.12.2023
A	DEBITOR BIZNESI 2023	26,835,864	3,336,045	255,720	29,916,189
1	Biznes i madh	23,476,106	3,143,056	255,720	26,363,442
2	Biznes i vogel	3,359,758	192,989	0	3,552,747
B	Debitore taksa e tarifa vendore 2023	47,861,896	7,921,757	5,182,111	50,601,542
1	Qyteti Poliçan familjaret	3,238,626	1,046,647	364,004	3,921,269
2	Njësia administrative Vertop	12,523,355	2,663,263	2,837,795	12,348,823
3	Njësia administrative Terpan	32,099,915	4,211,847	198,0312	34,331,450
	GJITHSEJ A +B	74,697,760	11,257,802	5,437,831	80,517,731

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Bashkia Poliçan lidhur me gjëndjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik, në fund të vitit 2022 rezulton në një numër prej 79 subjekte debitorë në vlerën 26,835,864 lekë, si rrjedhojë detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 rezulton për 6 subjekte në vlerën 3,080,325 lekë. Në fund të vitit 2023 mbetet vlera debitorë progresive është për 85 subjekte në vlerën 29,916,189 lekë.

Në vijimësi të analizës si më lart theksojmë se pjesa me e madhe e detyrimit nga subjektet “fizik/juridik” vjen si pasojë e mos pagesës nga subjekti “Kombinati Mekanik Poliçan” ku është debitorë për vlerën 20,163,230 lekë ose 67 % ndaj totalit të detyrimit nga “Bizneset”. Lidhur me këtë detyrim i cili daton që prej vitit 2017, Bashkia Poliçan ka bërë kërkesë Padi me nr.957 prot., datë 12.05.2021 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për mos likuidim detyrimesh nga vitet 2017-2021 për vlerën 14,988,423 lekë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka dalë me Vendimin nr. 242 prot., datë 12.04.2022, ku në këtë vendim gjykata është shprehur se, në këtë vështrim juridik nuk mund të merret në shqyrtim një padi kur në situatën faktike , aktuale, nuk njihet apo evidentohet cënimi i një të drejte pse i një interesi që mund të pretendohet nga kundrejt palës tjetër. Pas vendimit të marrë nga “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë” nga Bashkia Poliçan në cilësin e paditësit ka bërë kërkesë ankimore me shkresën 2213/1 prot., datë 22.09.2022, shkresë e cila ka si objekt kundërshtimin e vendimit nr.242 prot., datë 12.04.2022, e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë.

Taksat dhe Tarifat Familjare

Përsa i përket taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Poliçan ku familjarët ngarkohen me taksa dhe tarifa për Tokën, Banesën, Ndrëçimin dhe Shërbimet Publike nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore. Në tabelën e mëposhtme janë të identifikuar familjet debitorë: Numër familje debitorë.

Nr.	Debitor deri në fillim të vitit	Maturimi	Arkëtimet	Totali Debi
	2023	2023	2023	2023
1	689	1100	1074	715
2	694	583	1040	237
3	2424	3920	3987	2357
Totali	3807	5020	5518	3309

Burimi: Bashkia Poliçan

Vlerat debitorë përkatëse si më poshtë:

Nga auditimi konstatohet se, debitorë për taksa dhe tarifa vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Poliçan deri në datën 31.12.2022 janë 3807 familje debitorë në vlerën 47,861,896 lekë, , dhe në fund të vitit 2023 janë 3,309 familje në vlerën 50,601,542 lekë.

Detyrimi tatimor në Bashkinë Poliçan është në vlerën 80,517,731 lekë, vlerë e cila përbëhet nga debitorët e bizneseve, dhe debitorët nga familjarë, Drejtoria e taksave dhe e Tarifave Vendore ka dërguar në financë shkresën me nr. 411 prot., datë 15.02.2024, lidhur me njoftimin për azhurnimin e listës së debitorëve për vitin 2023 konkretisht :

-Lisata e subjekteve debitor Bashkia Poliçan, Nja. Vertop, viti 2023.

-Lista e debitorëve për taksat familjare viti 2023.

-Lista e tokës Bujqësore për Bashkinë Poliçan, Nja. Vertop dhe Terpan

-Përmbledhëse e debitorëve , biznes, taksa familjare, taksa e tokës bujqësore, për Bashkinë Poliçan Nja. Vertop dhe Terpan për vitet 2011-2023.

Për taksat dhe tarifatat vendore për abonentët familjarë në Bashkinë Poliçan, konstatohet se, pjesa më të madhe e detyrimi të krijuar ka ardhur si rezultat i debitorëve për taksën e tokës bujqësore ku rezulton në vlerën 47,448,523 lekë ose 93.7 % të totalit të “*debitorëve nga familjarët*”, dhe 58.9 të “*totalit të debitorëve*”.

Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Poliçan është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Nuk janë ndërmarrë hapat sikurse janë të përcaktuara në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë që kryejnë aktivitetin e tyre pranë Bashkisë Poliçan si dhe është kërkuar për 3 subjekte urdhër bllokimi i llogarive bankare. Nga auditimi konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar ndaj debitorëve të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Poliçan, u auditua dokumentacioni për vitin 2023, i paraqitur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Zhvillimit Urban. Në Bashkinë Poliçan deri në 31.12.2023, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë. Nga ZVASHK Poliçan, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësive Administrative të Bashkisë, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Poliçan, nuk janë marrë të gjitha masat për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore objekt legalizimi. Në vijim paraqiten pasqyra sintetike e numrit të debitorëve dhe vlerës së tyre, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit.

Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për lejet e legalizimit-viti 2023

Debitor TNI deri në 31.12.2023	Subjekte
31.12.2023	Vlera
Nga të cilat krijuar në 2023	80,669
Nga të cilat progresive deri në 31.12.2022	697,435
Vlera totale debitore deri në fund të vitit 2023	778,015

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se në fund të vitit 2022 vlera debitore nga mos pagesa e taksasës së ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 697,435 lekë, e cila i përket 21 abonentëve. Gjatë vitit 2023, janë faturuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë 21 abonentë me vlerë fature 632,577 lekë, nga ky detyrim është likuaduar vlera 551,908 lekë e cila i përket 14 abonentëve. Debitorë të krijuar gjatë vitit 2023 janë 7 debitorë për vlerën 80,669 lekë. Debitorë progresivë për taksën e ndikimit në infrastrukturë janë 28 abonentë me vlerë detyrimi 778,015 lekë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Poliçan, dhe agjentit tatimor përcaktuar në paketën fiskale VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022 ku përcaktohet se për kategorinë IV “Për ndërtesat në proces Legalizimi”, agjent tatimor është A.L.U.I.Z.N.I Berat. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”. VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

-Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Poliçan mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i rregjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Poliçan, që korrespondon me vitin 2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimin dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”;

-Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Poliçan dhe në Njësitë Administrative, na u vendosën në dispozicion 6 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Pajisur me Licence		Licence		Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer
		Po	Jo	Fillon	Mbaron		
1	Xh	+		04.05.2020	04.05.2025	1,000,000	Po
2	B Shpk	+		12.02.2021	12.02.2022	200,000	po
3	R Sh.P.K	+		30.04.2021	30.04.2026	1,000,000	po

4	K	+		28.02.2022	28.02.2023	200,000	po
5	L	+		01.08.2022	31.07.2027	1,000,000	po
6	Q	+		16.10.2023	15.10.2028	1,000,000	po

Burimi: Bashkia Poliçan.

Nga auditimi rezultoi se, për 6 (Gjashtë) nga autorizimet e dhëna nga Bashkia Poliçan nga të cilat në 4 (Katër) raste është dhënë autorizim për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe në 2 (dy) raste është dhënë autorizim për një periudhë 1 (një) vjeçare. Nga verifikimi i pagesave lidhur me autorizimet e dhëna nga Bashkia Poliçan rezultoi se janë kryer pagesat sipas autorizimeve përkatëse lidhur me subjektet e përmendur më lart.

Përlllogaritje të grupit të auditimit të tarifës së pastrimit nga subjekte që kanë ushtruar aktivitet në fushën e ndërtimit me NIPT sekondar në Bashkinë Poliçan dhe NJA, me fonde publike.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Poliçan mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit nga Bashkia Poliçan, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- VKB për miratimin e paketave fiskale 2023;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2023 - 31.12.2023;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga zyra e prokurimeve dhe nga Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Poliçan, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Poliçan të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

Nga të dhënat Rezulton se në territorin e Bashkisë Poliçan, kanë kryer punime ndërtimi kryesisht rkonstruksione nga 5 subjekte, të cilët janë me adresë sekondare. Nga auditimi konstatohet se për subjektet e cituar më lart është faturuar vlera prej 190,240 lekë për të cilën nuk janë kryer arkëtime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Poliçan. Gjithashtu konstatohet se, nga kryqëzimi i informacionit me drejtorinë e financës vlera debitore e cituar më lart nuk është regjistruar në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Shkronjën "a" e pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; Pikën 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore".

Bazuar në evidencën e prokurimeve subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë Poliçan për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, si dhe detyrimi për tarifën e shërbimit, pasqyrohen në vijim:

Nr	Objekti i Prokurimit/Leja e ndertimit	OE	Kohezgjatja e punimeve		Faturuar	Detyrimi
			Filluar	Mbaruar		
1	Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i rrugeve te varrezave te vjetra , lagjia Kalluc dhe pallati katerkatesh	Z	15.10.2023	08.08.2023	41,120	41,120
2	Rikonstruksioni i shkolles 9 vjecare "70 Vjetori i Pavarsise " dhe sistemimi i jashtem i gjihte kompleksit arsimor	B	19.09.2023	vazhdim	72,000	72,000
3	Riparimi i rrugeve te fshtrave Peshtan , Drenove , Lybesh, Tomor i Madh, Tomor i Vogel" 22	B	09.12.2022	09.01.2023	6,000	6,000
4	Shpenzime per rikonstruksionin e Shkolles"Muhamend Kondi" Poliçan	Z	01.11.2022	03.04.2023	41,120	41,120
5	Mbrojtje lumore gjatesore nga lumi Osum , fshati Mbrakull , Polican	A	08.08.2023	07.12.2023	30,000	30,000
TOTAL 2023						190,240

Burimi: Bashkia Poliçan

Konkluzion:

Debitorë të pa arkëtuar deri në datën 31.12.2023 janë në vlerën **80,517,731** lekë detyrimi cili përbëhet nga si më poshtë vijon:

- Debitorë nga bizneset për 85 biznese në vlerën 29,916,189 lekë.
- Debitorë nga familjarët për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 50,601,542 lekë për 3309 abonentë familjarë.

Këto detyrime janë të kontabilizuara.

Të ardhura të munguara deri në datën 31.12.2023 janë në vlerën **1,179,455** lekë detyrimi cili përbëhet nga si më poshtë vijon:

- Nga mos llogaritja e kamatë vonesës për kontratat e dhëna me qera në vlerën 211,200 lekë.
- Për subjektet e ndërtimit, të cilët kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike për vlerën 190,240 lekë
- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja në vlerën 778,015 lekë.

Këto detyrime nuk janë të kontabilizuara.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, konkretisht VKB për miratimin e paketave fiskale 2023; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c neni 4, pika 7. Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. Neni 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore” Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, ngarkohen me përgjegjësi; zj. A.C Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, zj.S.Q specialiste e tatimit detyrimeve fiskale dhe mbledhjes së taksës së tokës në njësinë Terpan. z. K.K specialist i tatim taksave në Njësia Vërtop.

Pika 2.5. “Mbi procedura e dhënies me qira të pronës publike dhe likuidim i detyrimeve për kontratat e lidhura”, u shqyrtuar dokumentacioni me përzgjedhje si më poshtë:

1. Procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore nga Njësiti Administrative në juridiksionin e Bashkisë Poliçan, për periudhën janar-dhjetor 2023.
2. Procedurat e dhënies me qira të fondit pyjor, kullosor nga Bashkia Poliçan, për periudhën janar-dhjetor 2023.
3. Likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të tokës bujqësore nga Bashkia Poliçan, për periudhën janar-dhjetor 2023.
4. Likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor, kullosor nga Bashkia Poliçan, për periudhën janar-dhjetor 2023.

2.5/a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipër cituar konstatohet që:

1. Nga dokumentacioni i me zgjedhje i vënë në dispozicion nga Bashkia Poliçan për periudhën objekt auditimi janar-dhjetor 2023, rezulton se nga Bashkia Poliçan nuk është lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore. Në Bashkinë Poliçan ndodhen 5 kontratë qiraje “Për dhënie me qira të tokës bujqësore” që i përkasin periudhave të mëparshme me sipërfaqe totale prej 89.11 ha, ku 4 kontrata janë të lidhura nga ish-Komuna Vërtop sipas tabelës:

Nr.	Qiramarësi	Nj.Ad.	Sip. ha	Objekti i Kont.	Afati në vite	Lidhja e kontrates datë	Vlera lekë/ha
1	Pellumb Dervishaj	Vërtop	0.32	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000
2	F.Xh	Vërtop	2.85	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000
3	Flamur Pupa	Vërtop	7	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000
4	Klodian Allajbeu	Vërtop	56.70	T,Bujqësore	99	11.11.2013	6,100
5	Perparim Jazexhiu	Mbrakull	22.24	T.B. Agrotu.	99	22.07.2019	6,000
TOTALI			89.11				

Burimi: Bashkia Poliçan

2. Në lidhje me auditimin e procedurave të dhënies me qira të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, nga Bashkia Poliçan.

Nga auditimi rezulton se, Bashkia Poliçan nga transferimi i sipërfaqeve me vendim të VKM-së janë pajisur me certifikatë pronësie në 10 raste për sipërfaqet kullimore që administrojnë, për këto sipërfaqe të regjistruar dhe të pajisur me certifikatë pronësie Bashkia Poliçan ka dhënë me kontratë qiraje fondin pyjor, kullor subjekteve të interesuar.

Në lidhje me auditimin e procedurave të dhënies me qira të fondit pyjor, kullor, rezultoi:

Nga Bashkia Poliçan janë lidhur gjithsej 5 kontratë për dhënie me qira të fondit pyjor, kullor me sipërfaqe totale prej 467.850 ha, sipas tabelës:

Nr.	Qiramarësi	Nj.Ad.	Sip. ha	Objekti i Kont.	Afati në vite	Lidhja e kontrates datë	Detyrimi në ha/lekë
1	V	Tërpan	2.880	Për (HEC)	2-5	30.09.2019	522,000
2	Vodaf. Albania Sha	Polican	50 m ²	Instalim Antene	9	16.04.2020	405,000
3	S	Tërpan	63.975	Panele fotovoltaike	10	30.08.2023	176,000
4	X	Tërpan	60	Panele fotovoltaike	10	30.08.2023	176,000
5	X	Tërpan	341	Panele fotovoltaike	10	05.12.2023	176,000
TOTALI			467.850				

Burimi: Bashkia Poliçan

Për përdhën objekt auditimi janar-dhjetor 2023 janë lidhur 3 kontratë për **dhënie me qira të fondit pyjor, kullor** me sipërfaqe totale prej **464.975 ha**, konkretisht:

1. Kontrata e lidhur në 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “S” përfaqësuar nga administratori z. D.H me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 63.975 ha, në ekonomin pyjore mali Tërpanit, ngastra nr.22 dhe 23, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 11,278,792 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

Kjo shumë prej 11,278,792 lekë është likuiduar brenda afatit datë 31.08.2023.

2. Kontrata e lidhur në 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të ka 60 ha, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

3. Kontrata e lidhur në 05.12.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 341 ha, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

Në lidhje me auditimin e procedurave për dhënie me qira të fondit pyjor, kullor, rezulton:

1. Nga subjekti “S” përfaqësuar nga administratori z. D.H, me datë 12.06.2023 është kërkuar të marrë me qira të fondit pyjor, kullor me sip. 63.975 ha ngastra nr. ne ngastrat 22 dhe 23 ekonomia pyjore mali Tërpan pasuria nr. 957, Z.K. 3584 e llojit “kullot” me sipërfaqe 417082m²

dhe pasurisë nr. 1888, Z.K. 3572, e llojit “kullot” me sip. 222668 m², Bashkia Poliçan "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.

Nisur nga kërkesa e subjektit nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me vendim nr.1, datë 28.6.2023 është miratuar në parim fillimi i procedurës ligjore për "Dhënie në përdorim të sipërfaqes se fondit pyjor/kullosor "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë".

Ky proces është kryer nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” dhe V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien ne shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Me Urdhër nr. 329, datë 26.06.2023 të Kryetari i Bashkisë Poliçan, është urdhëruar “Ngritja e njësisë së ankandit për përcaktimin e vlerës aktuale monetare të ankandit (VAM-i) ku vlera fillestare bazuar në procesverbalin i mbajtur, nga grupi i punës datë 18.07.2023 është përcaktuar shumë prej 11,278,792 lekë.

Nga Bashkia Poliçan nëpërmjet ankandit publik, data 14.08.2023, ora 10.00 është caktuar si datë e zhvillimit të ankandit. Procedura e ankandit është “Procedurë e Hapur”. Njësia e ankandit ka dërguar në APP njoftimin për fillimin e procedurës së ankandit, njoftim i cili është publikuar në Buletinin informues nr. 64, datë 24.07.2023 sipas ligjit për ankandet publike.

Me datë 14.08.2023 nga Njësia e Ankandit është mbajtur procesverbali “Për hapjen e dokumentacionit të ankandit me objekt “Dhënien në përdorim të fondit pyjor, kullosor me sip. 63.975 ha në ngastrat 22 dhe 23 ekonomia pyjore mali Tërpan pasuria nr. 957, Z.K. 3584 e llojit “kullot” me sipërfaqe 417,082 m² dhe pasurisë nr. 1888, Z.K. 3572, e llojit “kullot” me sip. 222,668 m² me vlerë fillestare 11,278,792 lekë referuar V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien ne shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Në konkurrim, paraqiti ofertën vetëm një shoqëri “M” shpk, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me bashkimin e gjashtë shoqërive, konkretisht shoqëritë “M” shpk, , “P” shpk, “A” shpk, “E” shpk, “P” shpk, e cila u kualifikua, pasi dokumentacioni i paraqitur prej saj ishte i plotë sipas udhëzimit të sipërcituar dhe publikimit në Agjencinë e Prokurimeve Publik.

Me datë 15.08.2023 Komisioni për Vlerësim të Ofertave (KVO), ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 403, datë 03.08.2023, i përbërë nga *I.G Ing. Kryetar dhe anëtar A.C Ekonomiste dhe H.N Agronom* ka shqyrtuar dokumentacionin që shoqëria “M” shpk.ka paraqitur.

Në përfundim KVO ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga konkurrenti, të rregullt dhe vlerëson ofertën e bashkimit të 6 shoqërive me 95 pikë në total, bazuar në kriteret dhe metodiken e përcaktuar në pikën 14 të Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit, Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

antarë të bashkimit të përkohshëm, tshpallur fitues janë regjistruar në QKB një muaj para se subjekti të bëjë kërkesë pranë Bashkisë Poliçan për marrje me qira të fondit pyjor, kullosor me sip. 63.975 ha, kjo provohet nga certifikata e regjistrimit dhe nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ku rezulton se 6 shoqëri janë regjistruar në QKB me datë 09/05/2023 po me këtë datë këto shoqëri janë themeluar me kapital:100.000 lekë.

Me vendim nr. 1, datë 16.08.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar raportin përfundimtar dhe shpalljen fitues të bashkimit të shoqërive “M” shpk, “P” shpk, “A” shpk, “E” shpk, “P” shpk.

Me datë 22.08.2023 nga Bashkia Poliçan është bërë edhe njoftim fitues për “Dhënien në përdorim të fondit pyjor, kullor me sip. 63.975 ha në ngastrat 22 dhe 23 ekonomia pyjore mali Tërpan pasuria nr. 957, Z.K. 3584 e llojit “kullot” me sipërfaqe 417,082 m² dhe pasurisë nr. 1888, Z.K. 3572, e llojit “kullot” me sip. 222,668 m² me vlerë fillestare 11,278,792 lekë, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë" drejtuar Agjencinë e Prokurimeve Publik.

APP në Buletinin nr.73, datë 28.08.2023, ka publikuar njoftuar e Bashkisë Poliçan për fituesin për dhënien me qira për shoqërinë “M” shpk, “P” shpk, “A” shpk, “E” shpk, “P” shpk për “Dhënien në përdorim të fondit pyjor, kullor me sip. 63.975 ha, në ngastrat 22 dhe 23 ekonomia pyjore mali Tërpan pasuria nr. 957, Z.K. 3584 e llojit “kullot” me sipërfaqe 417,082 m² dhe pasurisë nr. 1888, Z.K. 3572, e llojit “kullot” me sip. 222,668 m² me vlerë fillestare 11,278,792 lekë, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë"

Me datë 30.08.2023 është lidhur kontrata e qirasë midis Kryetarit të Bashkisë Poliçan i përfaqësuar nga z. A.Z (qiradhënës) dhe subjektin “M” i përfaqësuar nga administratori z. D.H (qiramarrës), me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 63.975 ha, në ekonomin pyjore mali Tërpanit, ngastra nr. 22 dhe 23, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 11,278,792 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”. Në dosje është depozituar marrëveshja për shërbime profesionale” e lidhur me datë 18.08.2023 midis konsulentit “S” përfaqësuar nga znj. R.S me klientin shoqërinë “M” shpk me qëllim “konsulencë profesionale”.

Nisur nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “S”, rezulton se, në CV-në profesionale të shoqërisë “S” shpk, nuk rezulton që të ketë provojë (konsulentë) në fushën e veprimtarisë të prodhimit të energjisë elektrike nga Parqet Fotovoltaike, por për raportet teknike dhe për plan rehabilitimi “Për park Fotovoltaike me fuqi 60 kWp” ka lidhur kontratë pune më Ing. A.D, dhe me ekspertin e mjedist N.M.

Me datë 30.08.2023, 6 shoqëritë kanë lidhur një kontratë bashkëpunimi (për bashkimin e operatorëve ekonomikë), shoqëritë kanë rënë dakord me njëra-tjetrën që të përmbushur të gjithë hapat e nevojshme për tu pajisur me licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Parqet Fotovoltaike, ku do të përfaqësohet në çdo institucion nga shoqëria “M” shpk.

Nga auditimi i kriterëve të kërkuar nga Njësia e Ankandit rezulton se:

-Nga Njësia e Ankandit në kriteret e veçanta për zhvillimin e ankandit, ndër të tjera, është kërkuar edhe garancia financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes Nga “Përshkrimi i hollësishëm i projektit të investimit” në Raportin Teknik, rezulton se vlera totale e investimit të ri, për vendosjen dhe operimin e parkut fotovaltaik parashikohet të jetë 3,900,616,500 lekë ose 35,460,150 euro, nga të cilat 20% do të investohen nga fondet e ortakeve të shoqërisë dhe aktiviteti i shfrytëzimit në vazhdim dhe 80% do të financohen me kredi bankare ku koleterial do të jetë vetë projekti.

Nisur nga kapitali që këto shoqëri kanë të regjistruar në QKB rezulton se këto shoqëri nuk kanë të bashkëlidhur dhe të pasqyruar burimet financat për të investuar një shumë prej 35,460,150 euro. (Në dosje ndodhet vetëm një “Letër reference” datë 11.8.2023 nga P Bank, ku kjo e fundit shprehet se “ do të konsiderojë financimin e projekteve bazuar në kapitalin financiar të shoqërive konformë rregullores në fuqi për financimin e klientëve.”, që do të thotë se kriteri i kërkuar nga Njësia e Ankandit për garancinë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të

parashikuar në plan-biznes, nuk është zbatuar nga BOE pjesëmarrëse në ankand, ku nga KVO janë kualifikuar BOE pa e plotësuar kriterin e vendosur nga njësia e ankandit”.

-Nga Njësia e Ankandit nuk është kërkuar statusi juridik drejtuar DV ASHK Berat për pasuritë që ndodhen brenda sipërfaqes të dhënë me qira, në kundërshtim me nenin 20 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

2. Nga subjekti “X” shpk, regjistruar në datë 25.05.2022 me kapiatal 1.000.000 lekë me administrator z. Ç.I dhe ortak me 50% me Y.U, me datë 13.06.2023 është kërkuar fillimin e procedurës për dhënie me qira të pasurive shtetërore me sipërfaqe totale 60 ha, të ndodhura në fshatin Tërpan, Bashkia Poliçan “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

Nisur nga kërkesa e subjektit nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me vendim nr.1, datë 28.6.2023 është miratuar në parim fillimin e procedurës ligjore për "Dhënie në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kulloror "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë".

Ky proces është kryer nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik” dhe V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Me Urdhër nr. 375, datë 19.07.2023 të Kryetari i Bashkisë Poliçan, është urdhëruar “Ngritja e njësisë së ankandit për përcaktimin e vlerës aktuale monetare të ankandit (VAM-i) ku vlera fillestare bazuar në procesverbalin i mbajtur, nga grupit i punës datë 19.07.2023 është përcaktuar shumë prej 10,560,000 lekë.

Nga Bashkia Poliçan nëpërmjet ankandit publik, data 21.08.2023, ora 10.00 është caktuar si datë zhvillimi i ankandit. Procedura e ankandit është “Procedurë e Hapur”. Njësia e ankandit ka dërguar në APP njoftimin për fillimin e procedurës së ankandit, njoftim i cili është publikuar në Buletin informues nr. 66, datë 31.07.2023 sipas ligjit për ankandet publike.

Me datë 21.08.2023 nga Njësia e Ankandit është mbajtur procesverbali “Për hapjen dhe dokumentacionit të ankandit me objekt “Dhënien në përdorim të sip. 60 ha, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, bazuar në V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore". Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga I.G Ing. Kryetar dhe anëtar A.C Ekonomiste dhe H.N Agronom ka pranuar dokumentacionin e paraqitur nga konkurrenti, të rregull dhe vlerëson se oferta e shoqërisë “X” shpk me, në adresë: Lezhë, Shëngjin “Mali i Rencit” rruga e plazhit me administrator Ç.I me 95 pike.

Me vendim nr. 1, datë 22.08.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar raportin përfundimtar të paraqitur nga Njësia e Ankandit dhe nga KVO duke shpallur fitues shoqërinë “X” shpk.

Me datë 23.08.2023 nga Bashkia Poliçan është bërë edhe njoftim fitues për “Dhënien në përdorim me sip. 60 ha, pasuria nr. 1890/1, Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 6,400 m², pasuria nr. 974/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 240,090 m², pasuria nr. 1378/1, Z.K. 3619, e llojit “Kullot” me sip. 353,510 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë" drejtuar Agjencinë e Prokurimeve Publik.

APP në Buletin nr.73, datë 28.08.2023, ka publikuar njoftuar e Bashkisë Poliçan për fituesin për dhënien me qira për shoqërinë “subjekti “X” shpk për “Dhënien në përdorim të fondit pyjor, kullor me sip. 60 ha, pasuria nr. 1890/1, Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 6400 m², pasuria nr. 974/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 240,090 m², pasuria nr. 1378/1, Z.K. 3619, e llojit “Kullot” me sip. 353,510 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë".

Me datë 30.08.2023 është lidhur kontrata e qirasë midis Kryetarit të Bashkisë Poliçan i përfaqësuar nga z. A.Z (qiradhënës) dhe subjektin X” shpk i përfaqësuar nga administratori z. Ç.I (qiramarrës), me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 60 ha, pasuria nr. 1890/1, Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 6400 m², pasuria nr. 974/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 240,090 m², pasuria nr. 1378/1, Z.K. 3619, e llojit “Kullot” me sip. 353,510 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

Me datë 18.08.2023 është lidhur një “Marrëveshje për shërbime profesionale” midis konsulentit “S” regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur pranë QKB, datë 24/01/2022, përfaqësuar nga znj. R.S. me klientin shoqërinë “X” shpk me qëllim “konsulentë profesionale”.

Nga auditimi rezulton se nga Njësia e Ankandit në kriteret e veçanta për zhvillimin e ankandit, ndër të tjera, është kërkuar edhe garancia financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes. Në Raportin Teknik “Përshkrimi i hollësishëm i projektit të investimit” rezulton se vlera totale e investimit të ri, për vendosjen dhe operimin e parkut fotovoltaik parashikohet të jetë 3,287,155,905 lekë ose 31,814,135 euro, ku burimi i financimit nga banka do të jetë në masën 25,531,398 euro dhe nga ortaket 6.383.827 euro. Nisur nga kapitali që kjo shoqëri ka të regjistruar në QKB rezulton se kjo shoqëri nuk ka të bashkëlidhur dhe të pasqyruar burimet financiare për të investuar në shumën e deklaruar prej 6.383.827 euro. (Në dosje ndodhet vetëm një “Letër reference” datë 11.8.2023 nga P Bank, ku kjo e fundit shprehet se “do të konsiderojë financimin e projekteve bazuar në kapitalin financiar të shoqërive konformë rregullores në fuqi për financimin e klientëve.”, *që do të thotë se kriteri i kërkuar nga Njësia e Ankandit për garancinë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes, nuk është zbatuar nga OE pjesëmarrëse në ankand, ku nga KVO janë kualifikuar OE pa e plotësuar kriterin e vendosur nga njësia e ankandit”*.

3. Nga subjekti “X” shpk, regjistruar në datë 25.05.2022 me kapital 1.000.000 lekë me administrator z. Ç.I dhe ortak me 50% me Y.U, me datë 22.11.2023 është kërkuar pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit drejtuar Bashkisë Poliçan, bazuar në njoftimin për dhënie me qira të pasurive shtetërore me sipërfaqe totale 350 ha, të ndodhura në fshatin Tërpan, Bashkia Poliçan, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.

Nisur nga kërkesa e subjektit nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me vendim nr.30, datë 31.10.2023 bazuar në raportin teknik-ekonomik të paraqitur nga grupi i punës, është miratuar "Dhënie në përdorim të pasurive nr. 1890/3, Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 488,252 m², pasuria nr. 1889/3, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 1,410,000 m², pasuria nr. 1889/1, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 511,748 m² pasuria nr. 958/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 791,990 m², pasuria nr. 974/4, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 208,010 m² të shtrira në ngastrat 7,12,23,24 ekonomia pyjore Mali Tërpan Njësia Administrative Tërpan në pronësi të Bashkisë Poliçan sipas certifikatave të pronësie bashkëlidhur për qëllim vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë.

Ky proces është kryer nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" dhe V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Me Urdhër nr. 331, datë 01.11.2023 të Kryetari i Bashkisë Poliçan, është urdhëruar "Ngritja e njësisë së ankandit për përcaktimin e vlerës aktuale monetare të ankandit (VAM-i) ku vlera fillestare bazuar në procesverbalin i mbajtur nga grupit i punës datë 01.11.2023 është përcaktuar shumë prej 60,117,600 lekë, bazuar në V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Nga Bashkia Poliçan nëpërmjet ankandit publik, data 27.11.2023, ora 10.00 është caktuar si datë zhvillimi i ankandit. Procedura e ankandit është "Procedurë e Hapur". Njësia e ankandit ka dërguar në APP njoftimin për fillimin e procedurës së ankandit, njoftim i cili është publikuar në Buletinin informues nr. 90, datë 06.11.2023 sipas ligjit për ankandet publike.

Me shkresën nr. 3109 prot., datë 22.11.2023 nga Bashkia Poliçan i është drejtuar Agjencisë së Prokurimeve Publike Tiranë, njoftim "Për shtyrje afati të hapjes së ankandit për shkak të shpalljes së datës 27.11.2023 ditë pushimi sipas VKM nr. 652, datë 22.11.2023, ku njoftohet se ankandi do të zhvillohet në datë 30.11.2023, ora 10.00 në Bashkinë Poliçan, njoftim i cili është publikuar në Buletinin informues nr. 96, datë 30.11.2023 sipas ligjit për ankandet publike.

Me datë 30.11.2023 nga Njësia e Ankandit i ngritur me urdhër nr. 533, datë 01.11.2023, është mbajtur procesverbali "Për hapjen dhe dokumentacionit të ankandit me objekt "Dhënie në përdorim të pasurive nr. 1890/3, Z.K. 3572 e llojit "Kullot" me sipërfaqe 488,252 m², pasuria nr. 1889/3, Z.K. 3572, e llojit "Kullot" me sip. 1,410,000 m², pasuria nr. 1889/1, Z.K. 3572, e llojit "Kullot" me sip. 511,748 m² pasuria nr. 958/3, Z.K. 3584, e llojit "Kullot" me sip. 791,990 m², pasuria nr. 974/4, Z.K. 3584, e llojit "Kullot" me sip. 208,010 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë, referuar V.K.M-se Nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore".

Komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i miratuar me urdhër nr. 533, datë 01.11.2023 i përbërë nga O.N Ing. Kryetar dhe anëtar K.R Ekonomiste, H.N Agronom, D.Z Jurist dhe A.Sh Agronom, ka pranuar dokumentacionin e paraqitur nga konkurenti, të rregull dhe vlerëson se oferta e shoqërisë "X" shpk, në adresë: Lezhë, Shëngjin "Mali i Rencit" rruga e plazhit me administrator Ç.I, me 95 pikë.

Me vendim nr. 1, datë 30.11.2023, Kryetari i Bashkisë ka miratuar raportin përfundimtar të paraqitur nga Njësia e Ankandit dhe nga KVO duke shpallur fitues shoqërinë "X" shpk.

Me datë 30.11.2023 nga Bashkia Poliçan është bërë edhe njoftim fitues për "Dhënie në përdorim të pasurive nr. 1890/3, Z.K. 3572 e llojit "Kullot" me sipërfaqe 488,252 m², pasuria nr. 1889/3, Z.K. 3572, e llojit "Kullot" me sip. 1,410,000 m², pasuria nr. 1889/1, Z.K. 3572, e llojit "Kullot" me sip. 511,748 m² pasuria nr. 958/3, Z.K. 3584, e llojit "Kullot" me sip. 791,990 m², pasuria nr. 974/4, Z.K. 3584, e llojit "Kullot" me sip. 208,010 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë, "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë" drejtuar Agjencinë e Prokurimeve Publik.

APP në Buletinin nr.98, datë 04.12.2023, ka publikuar njoftuar e Bashkisë Poliçan për fituesin për dhënien me qira për shoqërinë "subjekti "X" shpk për "Dhënie në përdorim të pasurive nr. 1890/3,

Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 488,252 m², pasuria nr. 1889/3, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 1,410,000 m², pasuria nr. 1889/1, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 511,748 m² pasuria nr. 958/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 791,990 m², pasuria nr. 974/4, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 208,010 m² me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë "Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë".

Me datë 05.12.2023 është lidhur kontrata e qirasë midis Kryetarit të Bashkisë Poliçan i përfaqësuar nga z. A.Z (qiradhënës) dhe subjektin “X” shpk i përfaqësuar nga administratori z. Ç.I (qiramarrës), me afat 10 vjeçar “Për dhënie në përdorim të pasurive nr. 1890/3, Z.K. 3572 e llojit “Kullot” me sipërfaqe 488,252 m², pasuria nr. 1889/3, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 1,410,000 m², pasuria nr. 1889/1, Z.K. 3572, e llojit “Kullot” me sip. 511,748 m² pasuria nr. 958/3, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 791,990 m², pasuria nr. 974/4, Z.K. 3584, e llojit “Kullot” me sip. 208,010 m² (341 ha) me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.

Me datë 18.08.2023 është lidhur një “Marrëveshje për shërbime profesionale” midis onsulentit “3S C.” regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur pranë QKB, datë 24/01/2022, përfaqësuar nga znj. R.S. me klientin shoqërinë “X” shpk me qëllim “konsulentë profesionale”.

Nga auditimi rezulton se:

-Nga Njësia e Ankandit në kriteret e veçanta për zhvillimin e ankandit, ndër të tjera, është kërkuar edhe garancia financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes Nga “Përshkrimi i hollësishëm i projektit të investimit” në Raportin Teknik, rezulton se vlera totale e investimit të ri, për vendosjen dhe operimin e parkut fotovaltaik parashikohet të jetë 168,006,000 euro, për një sipërfaqe totale prej 341 ha, ku sipërfaqja që do të zejen panelet do të jenë 228 ha, ku me burime financimi nga banka në total do të jenë 134,404,800 euro dhe burim financimi nga ortaket për vitin 2024 do të jete 11.200.400 euro.

Nisur nga kapitali që kjo shoqëri ka të regjistruar në QKB rezulton se kjo shoqëri nuk ka të bashkëlidhur dhe të pasqyruar burimet financat për të investuar për shumën e deklaruar prej 11.200.400 euro. (Në dosje ndodhet vetëm një “Letër reference” datë 11.8.2023 nga P Bank, ku kjo e fundit shprehet se “ do të konsideroje financimin e projekteve bazuar në kapitalin financiar të shoqërive konformë rregullores në fuqi për financimin e klientëve”, që do të thotë se kriteri i kërkuar nga Njësia e Ankandit për garancinë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes, nuk është zbatuar nga OE pjesëmarrëse në ankand, ku nga KVO janë kualifikuar OE pa e plotësuar kriterin e vendosur nga njësia e ankandit”.

Konkluzion: Në 3 rastet e sipërcituar, është dhënë me qira fondi pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, një sipërfaqe prej **464.975 ha, ku vlera e investimit shkon në total rreth 168,073,274 euro**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk i është vlerësuar Operatoreve Ekonomik kriteri i vendosur nga Njësia e Ankandit “Për garancinë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes”, që do të thotë që subjektet nuk kanë paraqitur një “Deklaratë mbi deshminë financiare të besueshme për mbulimin e financimit të projektit”.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) për arsye se nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk i është vlerësuar Operatoreve Ekonomik kriteri i vendosur nga Njësia e Ankandit “Për garancinë financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes”,

1. Znj. O.N, me detyrë Ing. në cilësinë e Kryetarit të KVO.
2. Znj. K.R, me detyrë Ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KVO.
3. Z. H.N, me detyrë Agronom, në cilësinë e anëtarit të KVO.
4. Znj. D.Z, me detyrë Jurist në cilësinë e anëtarit të KVO.
5. Z. A.Sh, me detyrë Agronom, në cilësinë e anëtarit të KVO.
6. Znj. I.G, me detyrë Ing. në cilësinë e Kryetarit të KVO.
7. Znj. A.C, me detyrë Ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Ndërsa 2 kontratat e tjera e dhënies me qira të fondit pyjor, kullor nga Bashkia Poliçan janë lidhur në periudhën 2019 dhe 2020.

1. Në datë 30.09.2019 është lidhur kontratë qiraje me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “V” me afat 2-5 vjet për dhënie në përdorim të 3.6 km ose 2.88 ha, qiraja e dhënë është me një vlerë qiraje vjetor prej 522,000 lekë, për ushtrimin e veprimtarisë “V”.
2. Në 16.04.2020 është lidhur kontratë qiraje me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “V” Sh.a. me afat 9 vjeçar për dhënie në përdorim të 50 m², me një vlerë qiraje vjetor prej 405,000 lekë, për ushtrimin e veprimtarisë “Instalim Antene”.

2.5/b. Likuidimi i detyrimeve për kontratat e dhëna me qira të pronës publike për periudhën janar-dhjetor 2023, u shqyrtuar dokumentacioni me përzgjedhje si më poshtë:

1. Dokumentacioni i likuidimit të detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të tokës bujqësore nga Njësitë Administrative në juridiksionin e Bashkisë Poliçan.
2. Dokumentacioni i likuidimit të detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor, kullor nga Bashkia Poliçan.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipër cituar konstatohet që:

Të ardhurat totale, nga dhënia me qira të pronës publike për periudhën janar-dhjetor 2023, janë në shumën prej 83,648,490 lekë, konkretisht:

1. Likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të tokës bujqësore nga Bashkia Poliçan është sipas tabelës:

Nr.	Qiramarrësi	Nj.Ad.	Sip. ha	Objekti i Kont.	Afati në vite	Lidhja e kontrates datë	Detyrimi vjetor në lekë	Shuma e likuiduar në lekë	Data e pagesës për 2023
1	P.D	Vërtop	0.32	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000	1,920	01.02.23
2	F.Xh	Vërtop	2.85	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000	17,100	01.09.23
3	F.P	Vërtop	7	T,Bujqësore	99	27.03.2008	6,000	43,405	20.10.23
4	K.All	Vërtop	56.70	T,Bujqësore	99	11.11.2013	6,100	345,870	29.09.23
5	P.J	Mbrakull	22.24	T.B. Agrotu.	99	22.07.2019	6,000	133,453	15.06.23
TOTALI			89.11					541,748	

Burimi: Bashkia Poliçan

Në lidhje me auditimin e likuidimit të detyrimeve për kontratat e lidhura rezulton se nga Bashkia Poliçan janë lidhur gjithsej 5 kontratë qiraje të tokës bujqësore dhe se detyrimi vjetor e 5 kontratave të lidhura për dhënie me qira të tokës bujqësore është 541,748 lekë. Nga auditimi rezulton se qiramarrësit bazuar në kontratat e lidhura me qiradhënësin Bashkia Poliçan, janë likuiduar brenda afatit e gjithë shuma e parashikuar, konkretisht:

1. Subjekti P.D (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 27.03.2008 me qiradhënës Komuna Vërtop, me përfaqësues Kryetarin e Komunës z. F.B, me afat 99 vjeçar me sipërfaqe 0.32 ha, me vendodhje Fshati Drenovë me nr. kadastral 92/B, kategoria VI, Komuna Vërtop, me vlerë vjetore 6000 lekë/ha në vit, shuma e detyrimit vjetor prej 1,920 lekë është likuiduar brenda afatit.

2. Subjekti F.Xh (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 27.03.2008, me qiradhënës Komuna Vërtop, me përfaqësues Kryetarin e Komunës z. F.B, me afat 99 vjeçar me sipërfaqe 2.85 ha, me vendodhje fshati Peshtan me nr. kadastral 958/A kategoria VI, Komuna Vërtop, me vlerë vjetore 6000 lekë/ha në vitë, shuma e detyrimit vjetor prej 17,100 lekë është likuiduar brenda afatit.

3. Subjekti F.P (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 27.03.2008 me qiradhënës Komuna Vërtop, me përfaqësues Kryetarin e Komunës z. F.B, me afat 99 vjeçar me sipërfaqe 7 ha, me vendodhje fshati Fushë-Peshtan me nr. kadastral 997/B sip. 1.6 ha kategoria VI, nr. 958/B sip. 4.2 ha kategoria VI dhe nr. 134/B sip. 1.2 ha kategoria IV, Komuna Vërtop, me vlerë vjetore 6000 lekë/ha në vit, shuma e detyrimit vjetor prej 43,405 lekë është likuiduar brenda afatit.

4. Subjekti K.A (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 11.11.2013 me qiradhënës Komuna Vërtop, me përfaqësues Kryetarin e Komunës z. F.B, me afat 99 vjet me sipërfaqe 56.7 ha, për pasurinë nr. 789/5 dhe 789/6 Z.K. 2935 Vol. 5, faqe 70 dhe 71, Njësia Administrative Vërtop, me vlerë vjetore 6100 lekë/ha në vit, shuma e detyrimit vjetor prej 345,870 lekë është likuiduar brenda afatit.

5. Subjekti P.J (Qiramarrës) rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me datë 22.07.2019. me qiradhënës Bashkia Poliçan me përfaqësues Kryetarin e Bashkisë z. A.Z, me afat 99 vjet me sipërfaqe 22.24 ha, për pasurinë nr. 346 me sip. 101.070 m² dhe pasurinë nr. 356 me sip. 121.353 m² Z.K. 2632 Vol. 10, faqe 118 dhe 127, me vlerë vjetore 6000 lekë/ha në vit, shuma e detyrimit vjetor prej 133,453 lekë është likuiduar brenda afatit.

2. U auditua dokumentacioni në lidhje me likuidimin e detyrimeve për kontratat e lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor, kullor nga Bashkia Poliçan, sipas tabelës:

Nr	Qiramarrësi	Nj.Ad.	Sip. ha	Objekti i Kont.	Afati në vite	Lidhja e kontrates datë	Detyrimi vjetor në lekë	Shuma e likuiduar në lekë	Data e pagesës për 2023	Kamat vonesë Pa likuiduar në lekë
1	V	Tërpan	2.88	Për (HEC)	2-5	30.09.2019	633,600	745,350	06.11.23	
2	V	Polican	50 m ²	Instalim Antene	9	16.04.2020	405,000	405,000		
3	S	Tërpan	6.39	Panele fotovoltaike	10	30.08.2023	176,000	11,278,792	31.08.23	
4	X	Tërpan	60	Panele fotovoltaike	10	30.08.2023	176,000	10,560,000	06.09.23	211,200
5	X	Tërpan	341	Panele fotovoltaike	10	05.12.2023	176,000	60,117,600	06.12.23	
Totali i debitorëve								83,106,742		211,200

Burimi: Bashkia Poliçan

Nga Bashkia Poliçan janë lidhur gjithsej 5 kontratë qiraje dhe se detyrimi vjetor e 5 kontratave të lidhura për dhënie me qira të fondit pyjor, kullor në totale është 83,106,742 lekë, nga auditimi rezulton se qiramarrësit bazuar në kontratat e lidhura me qiradhënësin Bashkia Poliçan në 4 raste janë likuiduar brenda afatit të parashikuar në kontratë e gjithë shumë e parashikuar, konkretisht:

1. Kontrata e lidhur në datë 30.09.2019 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “V” me afat 2-5 vjet për dhënie në përdorim të 3.6 km ose 2.88 ha, qiraja e dhënë është me një vlerë qiraje vjetor prej 633,000 lekë, për ushtrimin e veprimtarisë “V” shumë prej 633,000 lekë është likuiduar brenda afatit me datë 06.11.2023.

2. Kontrata e lidhur në 16.04.2020 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “V”. me afat 9 vjeçar për dhënie në përdorim të 50 m², me një vlerë qiraje vjetor prej 405,000 lekë, për

ushtrimin e veprimtarisë “Instalim Antene”, shumë prej 405,000 lekë është likuiduar brenda afatit 2023.

3. Kontrata e lidhur në 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “S” përfaqësuar nga administratori z. D.H me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 63.975 ha, në ekonomin pyjore mali Tërpanit, ngastra nr.22 dhe 23, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 11,278,792 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, shumë prej 11,278,792 lekë është likuiduar brenda afatit datë 31.08.2023.

4. Kontrata e lidhur në 05.12.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 341 ha, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 60,117,600 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, shumë prej 60,117,600 lekë është likuiduar brenda afatit datë 06.12.2023.

5. Kontrata e lidhur në 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, me afat 10 vjeçar për dhënie në përdorim të 60 ha, me një vlerë qiraje 176,000 lekë/ha, ku vlera e qirasë vjetor është 10,560,000 lekë, për “Vendosje stacionesh, bazamente për Panele Fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, shumë prej 10,560,000 lekë është likuiduar jashtë afatit datë 30.08.2023.

Lidhur sa më sipër,

Në kontratën e qirasë datë 30.08.2023 e lidhur midis qiradhënësit Bashkia Poliçan, me përfaqësues Kryetarin e Bashkisë Poliçan z. A.Z dhe qiramarrësit X, përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, rezulton se, nenin 5, pika 5.2. “Pagesa dhe regjimi i saj” të kontratës, pagesa e parë do të behet brenda 3 ditëve nga momenti i lidhjes së kontratës dhe datës së nënshkrimit nga palët.

Në neni 5.6 të kontratës citohet se “Në raste së qiramarrësi nuk do të kryejë pagesën sipas kushteve të vendosura sa më sipër, qiradhënësi përfiton një kamatë vonesë prej 0,01% për çdo ditë vonese, por jo më shumë së 10% e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse. Për efekt të llogaritjes së kamatë vonesës do të konsiderohet data e përcaktuar në pikën 5.2 dhe 5.3 të kësaj kontrate.

Nga auditimi i respektimit të afateve rezulton se:

Nga qiramarrësi pagesa është bërë me datë 06.09.2023, në shumen prej 10,560,000 lekë që do të thotë se pagesa e parë nuk rezulton të jetë kryer brenda 3 ditëve nga momenti i lidhjes së kontratës dhe datës së nënshkrimit nga palët, kjo provohet nga “transfera e bërë nga qiramarrësi në degën e thesarit Skrapar datë 06.09.2023”.

Nga specialisti i sektorit të tatim-taksave nuk është përlllogaritur kamatë vonesa për mos pagesë brenda afatit të parashikuar në kontratë, konkretisht: kamata ditore 0,01 % x 10,560,000 lekë/qiraja vjetore x 2 ditë/kamatë vonesë = 211,200 lekë.

Nga qiradhënësi nuk është respektuar neni 5.2. “Pagesa e Qirasë” e Kontratës së Qirasë lidhur në datë 30.08.2023.

Konkluzion: Nga Drejtoria e Tatim-Taksave nuk është përlllogaritur kamatë vonesa prej 2 ditësh, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” shpk, përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën prej 211,200 lekë, në kundërshtim me nenin 5.2. të kontratës së qirasë “Pagesa e Qirasë”.

Ngarkohet me përgjegjësi, për mos përlllogaritjen e kamatë vonesës për mos pagesë brenda afatit të parashikuar në kontratë, në kundërshtim me nenin 5.2. të kontratës së qirasë “Pagesa e Qirasë”.

1. A.C, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Tatim-Taksave, Bashkia Poliçan.

2. Ç.K, me detyrë specialist në Drejtorinë e Tatim-Taksave, Bashkia Poliçan.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).

Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.

Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruar nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e materialitetit 6,583 mijë lekë për shpenzimet, sipas Pasqyrës më poshtë:

PF.1 : Materialiteti për Bashkinë Polican 2023

000/Lekë

Emërtimi i Shpenzimeve 2023	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	141,931,300	0.70	19
Sigurime Shoqërore (601)	22,004,479	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	63,829,728	0.70	8
Investime të brend. (230-231)	3,673,842	2.00	1
Te tjera transfer. korrente (606)	97,747,864	0.70	13
Total	329,187,213		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	6,583,744		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	6,583,744		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	658,374		
Nëntotali	5,925,370		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	5,332,833		

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Polican për vitin 2023 janë të nënshkuara nga z. A.Z me detyrë Kryetar i Bashkisë Polican në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F.H me detyrë Drejtor i

Financës (*hartuesi i llogarive vjetore*) në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depozituar pranë Degës së Thesarit Skrapar me shkresën nr. 517 prot., datë 28.02.2024, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar më datë 28.02.2024.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

-Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementët që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj., Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e Pasqyrave Financiare të Bashkisë Polican për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekset pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike. Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të Degës së Thesarit Polican për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në formatin e pasqyrës së lëvizjes në Cash viti 2023.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Polican (pasqyrat financiare), Formatin nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

PF.2

Aktivët Neto janë të barabarta me Aktivët - Pasivët = Aktivët Neto	1,530,125,530
Aktivët	1,719,200,740
Pasivët	-189,075,210
Aktivët Neto	1,530,125,530

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

PF.3

Aktivët Afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën	262,384,604
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	98,314,455
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	17,918,218
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	146,151,931

Burimi: Bashkia Poliçan

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

PF.4 Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	98,314,455	16,249,352	82,065,103
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		98,314,455	16,249,352	82,065,103

Burimi: Bashkia Poliçan

Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2023, në vlerën 16,256,092 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 98,314,455 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 98,314,455 lekë.

Testimi i llogarisë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin ushtrimor 2023

Tabela 3.2 ANALIZA E PASQYRES SE FLUKSEVE MONETARE (Formati nr. 3) Llog 520

VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	
	98,873,025
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	290,937,644
Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor	150,424,600
Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	17,974,293
Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	
Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	95,362,721
Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	240,082
Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)	
Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	27,660,253
Te tjera, arketuar(+)	9,187,251
Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	-342,489,219
Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-48,379,798
Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-281,318,427
Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-12,790,994
Interesi I paguar(-)	
Tatime te paguara(-)	
Te tjera te paguara (-)	
VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	-13,034,464
Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	611,632,309
Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)	
Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)	13,027,117
Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)	
Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	-57,661,096
Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-580,032,794
Huadhenie e Nenhuadhenie(-)	
Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)	
Dividente te paguar(-)	
TRANSFERTA E TE TJERA	-3,773,458
Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-40,500
Transferime ne buxhet te Fondeve te perdorura(-)	-3,732,958
Levizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)	
Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	82,065,103
Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	16,249,352
Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	98,314,455

Burimi: Bashkia Poliçan

Për vitin 2023 nga verifikimi për cdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës së shpenzimeve e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit duke analizuar dokumentat e nxjerjes së llogarive nga thesari për cdo muaj, për shumat e llogarive në cdo muaj dhe në total për vitin ushtrimor rezultoi se nuk ka diferencë. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i vitit 2023 i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (celje) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve. Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 “Disponibilitete në Thesar” dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara, veprimet të paraqitura në tabelat e mësipërme.

2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

PF.5

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	2,990,113	2,588,435	401,678
32	Inventar i imët	14,928,105	15,828,891	900,786
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			0
34	Produkte		400,800	0
35	Mallra			0
36	Kafshë në rritje e majmëri			0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			0
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)			0
Totali		17,918,218	18,818,126	899,908

Burimi: *Bashkia Poliçan*

Llogaritë e Klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 17,918,218 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,990,113 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 14,928,105 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 899,308 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në Pasqyrën e Performancës Financiare në vlerën 899,908 lekë.

-Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet me vlerën prej 84,239,153 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 47,039,153 lekë për të cilën nuk na u paraqit analizë.

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

PF.6

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme	146,151,931	194,535,082	48,383,151
411	Klientë e llogari te ngjashme			0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			0
431	Tatime e taksa			0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			0
435	Sigurime Shoqërore			0
436	Sigurime Shëndetësore			0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			0
44	Institucione të tjera publike			0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes		0	0
468	Debitorë te ndryshëm	94,107,360.00	88,494,189	5,613,171
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	52,044,571.00	106,040,893	(53,996,322)
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			0
Totali		146,151,931	194,535,082	(48,383,151)
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-

481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	-	-

Burimi: Bashkia Poliçan

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 94,107,360 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 88,494,189 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2023 ka pësuar një rritje prej 5,613,171 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela PF.6 Paraqitja e llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2023 në lekë.

Nr	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2022	Debi	Kredi	Gjendje 31.12.2023
1	Debitorë nga klsh 1998-2021	11,266,064	0	98,700	11,167,364
2	Debitorë nga Prefektura	531,447			531,447
3	Debitorë nga ISSH	141,376		36,000	105,376
4	Debitorë nga tatim taksat	74,697,760	16,368,316	10,548,345	80,517,731
5	Debitor per taksen e pulles, bileta tregu, therje	400,050	125,000	306,000	219,050
6	Debitorë nga Auditi I brendshëm	1,457,492			1,457,492
7	Kontrollit te Sherbimit Social Berat nr. 144/5	0	108,900		108,900
	Totali	88,494,189	16,602,216	10,989,045	94,107,360

Burimi: Bashkia Poliçan

-Nga analizimi i regjistrave të debitorëve në Bashkinë Poliçan, konstatohet se vlera e debitorëve që rrjedhin nga detyrimet nga taksat dhe tarifave vendore për vitin objekt auditimi deri në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 80,517,731 lekë, të cilat janë kontabilizuar të plota dhe rakordojnë me vlerat e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe të Ardhurave.

- Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 52,044,571 lekë e cila kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. U konstatua se: nuk ka diferencë midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në Pasqyrën PF.7 më poshtë dhe përbëhet nga:

Lekë

Emërtimi I llogarive	Vlera
Llogaria 401-408 “Furnitorë E Llogari Të Lidhura Me To”	37,284,134
Llogaria 467 “Kreditorë Të Ndryshëm”	0
Paqa Personeli Llogaria 42	10,699,258
Tatimi Mbi Të Ardhurat Llogaria 431	441,560
Sigurime Shoqërore Llogaria 435	3,157,975
Sigurime Shëndetësore 436	431,645
Totali	52,044,571

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, vlera e kësaj llogarie përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të financuara në vitin ushtrimor. Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv të bilancit në vitin 2023 në vlerën prej 0 lekë, e analizuar më poshtë.

Nr	Emertimi	Celja	Shtesa	Pakësim	Mbetja
1	Kuotizacionet per sindikaten e arsimit	0	16,200	16,200	0
2	Pakësim detyrime të prapambetura	0	877,509	877,509	0
	Totali	0	893,709	893,709	0

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes

së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara".

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFATGJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21-28 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

PF.7

Llog.Kontabel	Përshkrimi i llogarive	Çelje 2023	Shtesa 2023	Pakësim/amortizim 2023	Gjendje në fund
	I.Aktive afatgjata materiale	1,057,420,323	628,858,411	227,191,038	1,452,122,282
20	II. Aktive Afatgjata jo materiale	1,200,014	0	180,002	1,020,012
210	Toka ,troje, Terrene	1,188,000	0	0	1,188,000
211	Pyje, Kullota Plantacione	0	959,760	0	959,760
212	Ndërtesa e Konstruksione	298,458,629	114,734,518	14,302,357	389,890,790
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	723,347,703	491,073,862	204,088,512	1,003,774,516
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	699,321	4,363,480	465,731	4,595,901
215	Mjete transporti	23,910,936	11,200,853	5,528,911	29,582,878
216	Rezerva shtetërore	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	9,745,360	6,525,938	2,805,527	13,060,063
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	70,374	0	0	70,374
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0	0
Total (I+II)		1,058,620,337	628,858,411	227,371,040	1,453,142,294

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 "Studime dhe kërkime" më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,200,014 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa. Pakësim është përlllogaritur vetëm amortizim i akumuluar në vlerën 180,002 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,020,012 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	Vlera/lekë
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,704,895
	2	Amortizim i akumuluar	1,504,881
	3	Gjendja në 01.01.2023 Neto	1,200,014
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	3	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	180,002
	6	Gjendja neto më datë 31.12.2023	1,020,012

Burimi: Bashkia Polican.

Konkluzion.1 : Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se: për llogarinë nr.202 "Studime dhe kërkime", nuk ka patur shtesa dhe pakësime, ku kosto historike paraqitet në vlerën 2,704,085 lekë duke zbritur amortizimin e akumuluar në vlerën 1,684,883 lekë, teprica neto (vlera kontabël neto) paraqitet në shumën prej 1,020,012 lekë.

Nga auditimi rezulton se nuk ka analiza për vlerën 2,704,895 lekë që vjen nga bashkimi i bilanceve me Komunën Vërtop, në vitin 2015, veprimi është në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, i ndryshuar, datë 9.03.2018 "Për procedural e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 11.

Ndërsa për vlerat e studimeve e mbetura në këtë llogari dhe vlerat bruto të projekteve e reja të investimeve të cilat do të mbeteshin gjendje në fund të vitit ushtrimor, llogaritja e amortizimit bëhet në masën 15% .

Për këto aktive nuk ka inventar, si dhe nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, gjithashtu në pjesën më të madhe të Ilgoarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, analitiku i kësaj llogarie ka mangësi të theksuara pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve, viti i krijimit të tyre, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26 ku citohet: “Cdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”, pika 30 ku citohet: “Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”

2. Aktivitet Afatgjatë Materiale.

-Llogaria nr.210 “Toka, troje, terrene” paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 1,188,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 1,188,000 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqiten në vlerën prej 1,188,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 1,188,000 lekë.

- Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i truallit, shesheve, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap IV. pika 74 dhe 96.

-Llogaria nr.211 “Pyje kullota plantacione” në datën 01.01.2023, paraqitet në vlerën neto 0 lekë. Gjatë vitit ushtrimor 2023 është shtuar vlera prej 959,760 lekë. Vlera e amortizimit e akumuluar paraqitet në vlerë neto 0 lekë në fund të vitit 2023. Gjendja e kësaj llogarie është paraqitur në pasqyrën, si më poshtë:

PF.8

Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
	3	Gjendja në 01.01.2023	0
	4	Shtesa gjatë vitit 2023	959,760
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	959,760

Burimi: Bashkia Polican.

Më hollësisht në PF.9 si më poshtë vijon janë detajuar edhe transferimet me VKM për pyjet dhe kullotat në bashkinë Polican.

Nr.	Emertitimi i aktivitetit	Vlera / kosto historike 31.12.2023
1	Pyll prodhues (geshtenja) Zona kadastrale 3019 ,Nr. pasurise 112a, sipërfaqe 135000 m2, mbi rrugën Unaza e Plirezes Polican, datë leshimi I pronësise 23.6.2010 , VKM nr. 896,dt. 11.6.2008	0
2	Pyll (pishe e eger) Zona kadastrale 3019 ,Nr. pasurise 12d, sipërfaqe 26000 m2, Anes Rruges Unaza e Plirezes Polican, datë leshimi I pronësise 23.6.2010 , VKM nr. 896,dt. 11.6.2008	0
3	Fidane pemë dekorative blerje me pagesë	959,760
	Shuma	959,760

-Në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Polican, të transferuara me VKM nr. 896, datë 11.6.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisë Vendore, Bashkisë Polican, Qarkut Berat". Sipas këtij vendimi Bashkia Polican ka në pronësi gjithsej 161,000 m2 nga të cilat 135,000 m2 pyll prodhues (gështenja), 26,000 m2 pyll

(pishë e egër). Veprimi është në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi I, pika 2 klasa 2.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit. Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk paraqet vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 08, datë 09.03.2018 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, kap IV. pika 74, pika 96, "Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi.

Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit". Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara në gjetjet e mësipërme, për periudhën 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023 ngarkohen me përgjegjësi: z.A.Z, kryetar i Bashkisë Poliçan në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

-Llogaria nr.212 "Ndërtime konstruksione" më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën neto 298,458,629 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 114,734,518 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 14,302,357 lekë, ndërsa më datë 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 398,890,790 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në aneks bashkëlidhur aktkonstatimit:

PF.10

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 "Ndërtime Konstruksione"	Vlera
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	401,217,451
	2	Amortizim i akumuluar	102,758,822
	3	Gjendja në 01.01.2023	298,458,629
	2	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	114,734,518
	3	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	14,302,357
	4	Kosto historike	515,951,969
	5	Amortizim i akumuluar	117,061,179
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	398,890,790

Burimi: Bashkia Polican.

-Llogaria nr.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 1,003,774,516 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën neto prej 723,347,703 lekë. Referuar formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 1,212,459,458 lekë, me shtesa në vitin 2023 në shumën 491,073,862 lekë, dhe gjendje në fund në shumën 1,695,973,124 lekë. Analitiku i llogarisë nr.213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" përbëhet nga 168 objekte.

-Llogaria nr.214 "Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune", në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 4,595,901 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 699,321 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,110,102 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 10,469,114 lekë për të cilat ka inventar fizik. Gjatë vitit ushtrimor kemi pakësime nga kjo llogari të materialeve si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimit në vlerën 4,468 lekë.

-Llogaria nr.215 "Mjete transporti", në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 29,582,878 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën neto 23,910,936 lekë. Ndërsa referuar formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)", në fund të vitit 2022 paraqitet në koston historike prej 64,140,194 lekë dhe në fund të vitit 2023 në vlerën 75,341,047 lekë me shtesa në vitin 2023 në shumën 11,200,853lekë si pasojë e dhurimit të një mjeteve zjarrfikës. Analiza e

gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve deri në fund të vitit 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

PF nr.12: Llogaria nr.215 “Mjete transporti

Nr.	Emërtimi i aktivitetit	Vlera / lekë Bruto 31.12.2023
1	Kamion benz me 3 akse	2,640,000
2	Mercedes Benz	2,160,000
3	Autovetur fuoristrad tip defender	3,120,000
4	Mjeti ambulance	13,700,625
5	Mjeti me targe	1,488,000
6	Mjeti fadrome	3,480,000
7	Rul Ngjeshes	3,600,000
8	Eskavator me goma	5,400,000
9	Mjeti kamioçine	985,000
10	Autozjarrfikse Skoda	571,725
11	Mjeti Benz 322	1,000,000
12	Tojota	2,160,000
13	Furgon autoveture	882,000
14	Benz	600,000
15	Mitcubish	1,668,000
16	Kamjon me vinc	2,112,000
17	Autovinc	1,669,200
18	Zjarrfikse e tipit kamioncine Ford Ranger me superstrukture	16,903,644
20	Zjarrfikse Tip Rreko Barrilla	11,200,853
	Shuma	75,341,047

Burimi: *Bashkia Polican.*

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)” konstatohet se, për llogarinë 215 “Mjete transporti” për vitin ushtrimor 2023 është përlogaritur në rregull norma e amortizimit. Veprime këto në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 38,660,208 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesë në vlerën 6,525,938 lekë. Pakësim në vlerë 1,756,234 vlerë historik lekë si pasojë e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe amortizim i akumuluar në vlerën 30,369,849 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 13,060,063 lekë vlerë neto.

-Në analizën e gjendjes së llogarisë 218 "Inventar ekonomik" është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 5,742,796 lekë e 19 aktiveve, paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

PF nr.13

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Vlera/ lekë
1	Dron	154,560
2	Kamera te jashtme minimumi me pajisje	144,000
3	Fiber optik	42,000
4	Media konverter	36,000
5	Gjenerator	1,820,000
6	Gjenerator i vogel	14,000
7	Gjenerator i madh	65,000
8	Betonjere	60,000
9	Matrapik 1600 ë	20,000
10	Sharre Guri	886,800
11	Sharre me benzine	28,080
12	Sharre me korent	35,000
13	Shkalle treshe alumini	24,000
14	Vare	6000
15	Kendi I lojrave	778,680
16	Fshese me korent	30,000
17	Lavatriçe	69,300
18	Stola pushimi	660,000

19	Kend lojrave ne qender te qytetit	869,376
	Shuma	5,742,796

Burimi: Bashkia Polican.

Të cilat sipas klasifikimit kontabël i përket llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe llogarisë 212 “Ndërtime dhe konstruksione” veprime në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, ku në pikën 1 përcaktohet se: Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve, që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 të udhëzimit” dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.

Mbi përlllogaritjen e amortizimit

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë sipas normave të amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ushtrimore për cdo aktiv.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Aktivitet Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 0 lekë dhe kjo kuadron dhe rakordon me vlerën e pasqyrar në në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Procesi i inventarizimit:

Inventarizimi i aktiveve për vitin ushtrimor 2023, Bashkia Poliçan.

Në bazë të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Poliçan. Gjatë vitit 2023, me urdhrin e Titullarit të Bashkisë Poliçan, nr.593 dhe 594 datë 04.12.2023, për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimi për të gjitha aktivitetet e Bashkisë për vitin 2023.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrat e Bashkisë, magazinave dhe në NJA, në shkollë, kopshte, cerdhe, Bibliotekë, Pallati i Kulturës, Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023. Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve datë 29.12.2023. Nga komisioni i ngritur është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve ku janë mbajtur procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.35 datë 07.12.2023, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 859/2 prot, datë 15.12.2023 :”Mbi miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të identifikuar për vlerësim dhe të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit në shkollën 9- Vjeçare “70-Vjetori”, të Bashkisë Poliçan. Sipas këtij miratimi rezultoi se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

2. Llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 4,468 lekë.
3. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 1,631,840 lekë.
4. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 1,848,322 lekë.
5. Llog.219 “Amm i AAGJ” në vlerën 1,237,193 lekë.

Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me Urdher nr 617, datë 15.12.2023 “ Per ngritjen e komisionit te asgjësimit te materialeve te nxjerra jashte perdorimi nga komisioni i vlerësimit” prej 5 vetësh. Nga nxjerrja jashtë përdorimit aktivet me përmbajtje druri janë copëtuar dhe janë përdorur për dru zjarri. Janë hartuar relacionet mbi vlerësimin e inventarëve të Bashkisë Poliçan, si dhe janë firmosur nga Nëpunësi Autorizues. Janë hartuar procesverbalet e vlerësimit për materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, si dhe këto procesverbale janë miratuar dhe janë me firmën e Titullarit të Bashkisë Poliçan.

Te përshkrimi i dhënë në relacionet e vlerësimit thuhet që materialet të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi janë të pa përdorshme, kanë humbur cilësitë e tyre të përdorimit në kushtet teknike si dhe nuk mund të riparohen për tu’a rikthyer vlerën, megjithëse nuk u ka kaluar afati vlefshmërisë. Komisioni në këto kushte ka vlerësuar se këto materiale duhet të nxirren jashtë përdorimit nëpërmjet asgjësimit fizik.

Nga auditimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së procedurave dhe dokumentimit të procesit të inventarizimit të pasurisë së Bashkisë Poliçan u konstatua se:

- Në asnjë rast Nëpunësi Zbatues i njësisë nuk ka qenë kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 99, “Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxherë ose specialistë të financës si dhe specialistë të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i Njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit”;

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Gjendja e **llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimit 2023 paraqitet në vlerën 3,673,842 lekë, ku është kontabilizuar vlera për kontrata punimesh të cilat janë në proces zbatimi punimesh. Nga testimi i kontratave konstatohet se nuk ka kontrata punimesh të cilat janë ende të pa likuiduara nga viti 2023. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 231 në fund të vitit 2023					
Nr	Emertimi	Celja	Kreditim	Debitim	Mbetja
1	Investimet	47,039,153	568,745,031	612,110,342	3,673,842

Burimi i të dhënave: Bashkia Polican

B. PASIVET (Detyrimet)

Pasivi i Bilancit Kontabël 2023 Bashkia Poliçan

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Polican më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

PF nr.14 Lekë

		Viti 2023	Viti 2022
1. Llogari te Pagushme		189,075,210	222,589,101
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	37,284,134.00	93,899,952

42	Detyrime ndaj personelit	10,699,258.00	8,717,258
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	471,560.00	419,764
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	3,157,975.00	2,599,258
436	Sigurime Shendetsores	431,645.00	404,662
437,438,	Organizma te tjere shtetereore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	42,923,278.00	28,054,019
467	Kreditore te ndryshem		
4341	Operacione me shtetin(detyrime	94,107,360	88,494,189
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		

Burimi i të dhënave: Bashkia Polican.

-Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën 37,284,134 lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime energjie, internet të muajit dhjetor, për mallra dhe investime të paraqitura dhe analitikisht si më poshtë:

PF nr.15

	Pershkrimi	OE	Numri Fature	Data e Fatures	Shuma e Fatures
1	Riparimi i rrugëve të fshatrave Peshtan , Drenovë, Lybesh , Tomorr i Madh dhe Tomorri Vogël "	B Shpk	1/2022 1/2023	23.12.2022 13.01.2023	50,000
2	Energjia elektrike (me Akt marrëveshje)	O	Aktmarveshje	12.07.2018	675,185
5	Shërbim pastrim , gielbërim , dekor , miremb,varreza	C	3/2021	10.03.2021	298,931
6	Blerje materiale pastrimi	E.L	8/2023	08.08.2023	161
7	Internet	T	5/2021 9/2021	20.05.2021 22.07.2021	62,000
8	Blerje pjesë këmbimi , goma ebateri	S.A	36/2023	31.03.2023	600
9	"Rikonstruksion i Rruges Plirezës "		45 (seri 51343846)	11.10.2018	612,200
	Krijimi i qendres, parkimit, fshati Mbrakull	T	31 (seri 51343881	01.08.2019	13,418,720
10	Furnizimi me uje te pijshem te fshatrave Vertop , Vodice-Bregas - Fushe Peshtan	G	294/2021 909/2022 1896/2022	5.8.2021 26.7.2022 15.12.2022	14,400,000
11	Rikonstruksion shkolla e mesme M.Kondi 5 % garanci defektesh	Z	983/2022	22.11.2022	1,171,348
	Rikonstruksion shkolla e mesme M.Kondi	Z	331/2023,	16.05.2023	3,673,842
12	Telefon	A			23,597
13	Internet	A	32529566	30.12.2020	3,000
14	Blerje dhe instalim kamera vezhgimi bashkise "	I Shpk	46(seri 12190746)	30.04.2014	15,900
15	Blerje konteniere	B Shpk	225 (seri 10129025)	15.04.2014	29,700
16	Blerje automjet per bashkine	E Shpk	106(seri 18038306)	17.03.2015	74,400
17	Përmirësimi i banesave/ndërtimi ri për komunitete të varfëra	L Shpk	93/2022 .	10.03.2022	554,550
18	Qira objekti Pallati i Kulturës	K			2,220,000
	Totali				37,284,134

Burimi: Bashkia Polican.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlere 10,699,258 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të muajit Dhjetor.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatsisht në vlerat 2,599,258 lekë dhe 404,662 lekë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Polican në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 42,935,296 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Polican. Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

PF nr.16: Llogaria nr.466 në lekë

Nr	Emertimi	Gjendje 31.12.2023	Viti i Krijimit
1	Trashëguar nga ish komunat (të pa identifikuar).	206,900	2014
2	Trashëguar nga ish komunat (të pa identifikuar).	15,900	2014
3	Trashëguar nga ish komunat (të pa identifikuar).	29,700	2014
4	Trashëguar nga ish komunat (të pa identifikuar).	91,000	2015
5	Rikonstruksion i pjesës së brendshme të Bashkisë	136,535	2016
6	Rik.Rrug.Lagj Çelaj-Lagjia. Zotkaj (Mekam) Teman	83,951	2016
7	Ndertimi Ures Bejlit Uji i Zi Vokopol	58,476	2016
8	Bregu i Bardhe Lagjia Çelaj Fshati Teman	86,381	2016
9	Kthesa Lamaj Lagjia Shehaj Fshati Çorogjaf	35,928	2016
10	Mirembajtje e rruges Teman - Mekam	57,089	2016
11	Riparime dhe mirembajtje rruges	62,830	2016
12	Blerje Materiale Ndertimi	650,085	2016
13	Shtirim betoni, zgare Mbrakull	6,000	2016
14	Linja e derg te Ujesjell Polican Pronovik Mbrakull	212,200	2020
	Shuma	1,732,975	

Burimi: Bashkia Polican

Konkluzion nr.3 : Nga analiza e kësaj llogarie përbëhet nga 24 objekte nga të cilat për 14 objekte në vlerën prej 1,732,975 lekë, janë fonde që gjenden të ngurtësuar deri në vitin 2020, për të cilat është tejkaluar afati i garancisë dhe nuk është bërë zhbllokimi i tyre sipas kushteve të kontratave respektive. Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të bërë zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre në buxhetin e vet. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 12,741,433 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 19,578,048 lekë me një pakësim në vlerën 1,603,755 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

PF nr.17 Lekë

Llogaria	Emertimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	17,974,293	19,578,048
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	0	91,995
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale		
7001	Tatimi mbi fitimin		
7002	Tatim mbi biznesin e vogël		91,995
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		
702	2. Tatimi mbi pasurinë	12,555,590	13,015,056
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	12,555,590	12,929,880

7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	85,176
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	5,418,703	6,470,997
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	5,418,703	6,470,997
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	5. Taksë e rrugës		
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare		
709	7. Gjoha e kamatë vonesa		

Burimi: Bashkia Polican

2. Të ardhurat jo tatimore:

-Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 14,253,210 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 95,362,721 lekë me një rritje në vlerën 81,109,511 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	95,362,721	14,253,210
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	83,648,336	2,410,319
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	83,648,336	2,410,319
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	11,264,564	11,842,891
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	10,307,775	10,956,140
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	440,405	474,310
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	68,400	66,800
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestre e zhdëmtime	447,984	345,641
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	449,821	

Burimi: Bashkia Polican.

3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 504,125,622 lekë ndërsa në datën 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 925,254,660 lekë me një rritje në vlerën 421,129,038 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	925,254,660	504,125,622
720	1. Grant korent i brendshëm	925,254,660	504,125,622
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	637,926,505	214,372,217
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	230,691,706	179,590,706
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	4,351,795	3,413,288
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	52,044,572	106,040,893
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	240,082	708,518
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
721	2. Grant korent i huaj	0	0

	Nga Qeveri të huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

SHPENZIMET

-Llogaritë e shpenzimeve të konstatuara sipas Pasqyrë së Performancës Financiare, sipas natyrës dhe klasifikimit të këtij formati rakordojnë me shumtë e rezultuar në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor me akt rakordimet e thesarit. Pësha specifike e shpenzimeve pasqyrohet si më poshtë: Shpenzimet për llogarinë nr.600 “Paga shpërblime të tjera personeli”, në vlerën 141,931,300 lekë janë rreth 14% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë nr.601 “Kontribute të sigurime shoqërore dhe shëndetsore” në vlerën 24,498,319 lekë rreth 2.5% të totalit të shpenzimeve, shpenzimet për llogarinë nr.602 “Mallra dhe shërbimet të tjera” në vlerën 63,829,728 lekë rreth 6.6% e totalit, shpenzimet në llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individë” në vlerën 97,747,864 lekë zënë 10.2% të totalit të shpenzimeve, në të cilën përfshihen transferata për ndihmën ekonomike dhe për invaliditetin.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët. Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Nga testimi i shpërndarjes së karburantit për automjetet e bashkisë, rezultoi se fletë daljet kanë bashkëlidhur dokumentacion justifikues për secilin automjet, si kilometrat e përshkuara, vendin e kryerjes së shërbimit, targën e mjetit, autorizimin nga titullari dhe sasinë e tërhequr për secilin rast. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme për periudhën 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023 ngarkohen me përgjegjësi: z. A.Z, kryetar i Bashkisë Poliçan në cilësinë e Nëpunësit Autorizues znj. F.H detyrë Drejtor i Financës dhe Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

4.Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

4.1.Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe rregjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Për trajtimin e pikës 4.1. nga grupi i auditimit është shqyrtuar dokumentacioni me zgjedhje i vënë në dispozicion nga zyra e menaxhimit financiar dhe asetëve pranë Bashkisë Poliçan, në lidhje me listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në Bashkinë Poliçan si dhe procedurat e ndjekur për inventarizimin dhe regjistrimin në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Berat dhe Skrapar, konkretisht:

- Lista përfundimtare të pronave, **Pyjeve dhe Kullota**, që janë transferuar në pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore në **Bashkinë Poliçan**, të Qarkut të Beratit” të përfituara me VKM nr. 896, datë 11.06.2008.

- Lista përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, në **Komunën Tërpan**, të Qarkut Berat”, të përfituara me VKM nr. 735, datë 01.09.2010
- Lista përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, në **Bashkinë Poliçan**, të Qarkut Berat”, të përfituara me VKM nr. 207, datë 09.03.2011
- VKM nr. 476, datë 30.05.2013 “Për një ndryshim në VKM nr. 207, datë 09.03.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat”.
- Listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat” të miratuar me VKM nr. 916, datë 29.12.2007.
- VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” (Bashkia Poliçan, janë sipas shtojcës 5, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila përmban listën e inventarit që fillon me numrin rendor 1 (një) deri 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë).
- VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 “Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetërorë të ndërtesës së ish-Spitali, Poliçan”.
- VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me ve ndodhje në Poliçan.
- Kërkesat e bëra nga Bashkia Poliçan drejtuar drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Berat, për regjistrim të pasurive të përfituara më VKM-të përkatëse.
- Kërkesë drejtuar Ministrisë së Brendshme për miratimin e listës të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Njesisë Administrative Vërtop, të Qarkut Berat” të miratuar me VKM nr. 916, datë 29.12.2007.
- Dy Urdhëratë e Kryetarit të Bashkisë Poliçan për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 dhe VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018
- Kërkesa nga Bashkia Poliçan, drejtuar DV ASHK Berat dhe Skrapar, për regjistrim pasurie.
- Fletë regjistri i pasurive të paluajtshme të regjistruar në emër të Bashkisë Poliçan.

4.1/a. Inventarizimi dhe transferimi pronave të paluajtshme publike në juridiksionin e Bashkinë Poliçan:

Bashkia Poliçan, përbëhet nga dy Njësi Administrative, Tërpan dhe Vërtop. miratimi i listës të pronave të paluajtshme publike me VKM, është vetëm për Bashkinë Poliçan e cila është e miratuar me VKM nr. 207, datë 09.03.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat” dhe e ish-Komunës Tërpan, e miratuar me VKM nr. 735, datë 01.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Tërpan, të Qarkut Berat”, **ndërsa Njësia Administrative Vërtop që varet nga Bashkia Poliçan është vetëm me listë inventari të miratuar me VKM nr. 916,**

datë 29.12.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat”.

Nga verifikimi i listës të pronave të paluajtshme publike të miratuar me VKM, si dhe procedura në kryejnë e përditësimit të plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në Bashkinë Poliçan

rezultoi se në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1623 pasuri të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM.

Numri i pronave të Bashkisë Poliçan dhe i Njesisë Administrative Tërpan të miratuar me VKM janë gjithsej 1623 pasuri, ndërsa 2294 pasuri që janë në inventarë të Njesisë Administrative Vërtop nuk janë të miratuar me VKM.

Numri i pronave të Bashkisë Poliçan dhe i Njësive Administrative:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar/lista	Nr. Pronave në Inventar të transferuara dhe të miratuara me VKM	Nr. Praktikave të Certifikuara 2023	Nr. Praktikave të Certifikuara gjithsej	Prona të pa Regjistruara
1	Poliçan	940	940	-	43	897
2	Tërpan	683	683	10	10	673
3	Vërtop	2294	--	-	-	-
	TOTALI	3917	1623	10	53	1570

Burimi: Bashkia Poliçan

1. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 896, datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, Pyjeve dhe Kullota, që do të transferohen në pronësi të Njesisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Poliçan, të Qarkut të Beratit” vijon me listën me 1 (një) fletë që përfundon me numrin rendor 2 (dy) **gjithsej 2 pasuri.**

2. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM nr. 207, datë 09.03.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat” (shoqëruar me 3 formular inventarizimi), vijon me listën me 31 (tridhjetë e një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 88 (tetëdhjetë e tetë) **gjithsej 88 pasuri.**

Vendimi i sipërcituar shoqërohet me 3 formular:

-Formularin nr. 1 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave të veçanta” të tipit “truall ndërtese”, “rrugë” dhe “sheshe”, me fushë përdorimi “arsim” “shëndetësi”, “zhvillim ekonomik” “shërbime funerale”, “infrastrukturë”

-Formularin nr. 2 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave të veçanta të tipit Pyje, kullota, Livadhe, Shkëmbore”

-Formularin nr. 3 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vreshtë etj.” Në formularin nr. 3 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vreshtë reparte ushtarake, magazina, depo etj.”

3. Lista e pronave të paluajtshme të Bashkisë Poliçan, të transferuara me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” (Bashkia Poliçan, vijon me listën me numrin rendor 1 (një) deri 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë) **gjithsej 646 pasuri.**

4. Lista e pronave të paluajtshme të shtuara Bashkisë Poliçan, me VKM nr. 476, datë 30.05.2013 “Për një ndryshim në VKM nr. 207, datë 09.03.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të

Bashkisë Poliçan, të Qarkut Berat” shtohet prona me nr. 89-293 (tetëdhjetë e nëntë-dyqind e nëntëdhjetë e tre) gjithsej 29 (njëzet e nëntë) fletë, **gjithsej 204 pasuri.**

5. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme të **Njësisë Administrative Tërpan**, të transferuara me VKM nr. 735, datë 01.09.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Tërpan, të Qarkut Berat”, (shoqëruar me 3 formular inventarizimi), vijon me listën me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 798 (shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë), **gjithsej 683 pasuri.**

Vendimi i sipërcituar shoqërohet me 3 formular:

-Formularin nr. 1 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave të veçanta” të tipit “truall ndërtese”, “rrugë” dhe “sheshe”, me fushë përdorimi “arsim” “shëndetësi”, “zhvillim ekonomik” “shërbime funerale”, “infrastrukturë”

-Formularin nr. 2 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave të veçanta të tipit Pyje, kullota, Livadhe, Shkëmbore”

-Formularin nr. 3 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vresht etj.” Në formularin nr. 3 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme” ka lidhje me “inventarin e pronave që inventarizohet si klasa të veçanta të tipit, përrrenj, lumë, kanal, are, pemëtore, vresht reparte ushtarake, magazina, depo etj.”

6. Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësisë Administrative Vërtop, të miratuara me VKM nr. 916, datë 29.12.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Komunës Vërtop, të Qarkut Berat”, vijon me listën me 346 (treqind e dyzet e gjashtë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 2640 (dymijë e gjashtëqind e dyzet) **gjithsej 2294 pasuri.**

Lista e pronave të inventarizuara janë të klasifikuara:

Në përdorim

- Prona të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji;

Në pronësi

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social,

-Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik,

-Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e programeve arsimore,

-Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike),

-Shërbime funerale,

-Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (toka bujqësore joproductive dhe kanale të treta).

Në lidhje me mos miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim ***të Njësisë Administrative Vërtop*** në Bashkinë Poliçan të Qarkut Berat” për të cilën është miratuar vetëm lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore me VKM nr. 916, datë 29.12.2007 rezulton se:

Nga Bashkia Poliçan me shkresën nr. 1369 prot. datë 21.05.2018 i është drejtuar Agjencisë së Inventarizimit dhe transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore pranë Ministrisë së Brendshme, ku kërkohet miratimi i listës paraprake të pronës të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, bashkëlidhur shkresës

është dërguar lista e inventarit të pronave të paluajtshme të shtetit, vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 18.01.2018 si dhe kopje e shkresës së Prefekturës së Qarkut Berat me të cilën është konfirmuar vendimi.

Përsëri Bashkia Poliçan me anë të shkresës nr. 3276 prot. datë 15.11.2019 i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, Sekretarit të Përgjithshëm, për miratimin e listës paraprake të pronës të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit Bashkia Poliçan.

Në përgjigje të shkresës nr. 3276 prot. datë 15.11.2019, Ministria e Brendshme, ka kërkuar informacion pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, mbi procedurën e ndjekur nga ish-Agjencia e Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike për kalimin në pronësi të Bashkisë Poliçan të disa pasurive ku nga Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ku me shkresën nr. 20017/1 prot. datë 06.12.2019 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Poliçan është sqaruar se:

Me hyrjen në fuqi të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” ish-Agjencia e Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike është shkruar dhe praktikat në proces të ndjekura prej saj nuk kanë vijuar. Bazuar në pikën 3 të nenit 67 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” kompetencat e Agjencisë së sipërcituar i janë ngarkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rrjedhojë për vijimin e procedurës, kërkohet nga ana juaj si më poshtë vijon (në seri dokumentesh) për të cilën për disa prej kërkesave nga Bashkia Poliçan është e pamundur nga ana financiare që të plotësohen, për faktin se për çdo informacion që kërkohet nga Bashkia Poliçan për statusin juridik për të gjithë pronës e kërkuara nga DV ASHK Berat, kërkohet pagesa e tarifës së shërbimit, që do të thotë se që nga viti 2018 e deri në vitin 2024 nuk është bërë e mundur transferimi i 2294 pasuri dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, në kundërshtim me pikën 3 i nenit 67 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”.

Neni 67

Pika 3. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së

Me shkresën nr. 227 prot., datë 22.01.2020, Drejtori i Drejtorisë i Planifikimit të Territorit në Bashkinë Poliçan Ing. F.A, i është drejtuar Drejtorisë Juridike dhe Marrëdhënieve me Publikun për dijeni Kryetarit të Bashkisë, me një kërkesë “Për hartimin e planeve të rilevimit për pronat shtet”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 67 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” kompetencat e Agjencisë të Inventarizimit dhe transferimit të Pronave Publike i janë ngarkuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, ardhur me shkresën nr. 20017/1 prot. datë 06.12.2019.

Si pasojë e ndryshimeve ligjore “Drejtorja e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve” po përgatit materialin tekniko-ligjorë të pronave publike sipas ligjeve në fuqi (hartimi i listave të pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop), një ndër pikat ligjore për vazhdimin e procedurës për transferimin e pronave publike në pronësi të Bashkisë Poliçan është: Hartimi i hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë publike) të pasurive mbështetur në ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe VKM nr. 669, datë 9.8.2013 “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010)” i ndryshuar.

Për sa më sipër vijon në shkresë, kërkohet nga ana juaj të merrni masat për vazhdimin e procedurës për hartimin e planeve të rilevimit, sipas e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 669, datë 9.8.2013

“Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH-2010)” i ndryshuar, për çdo pasuri sipas listës bashkëlidhur.

-Lidhur me sa sipër nga drejtoritë përkatëse dhe nga Kryetari i Bashkia Poliçan nuk janë marrë masat për hartimin e planeve të rilevimit verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për të bërë të mundur transferimin e 2294 pasuri dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme të shtetit që janë brenda juridiksionit të **Njësisë Administrative Vërtop**, Bashkia Poliçan, në kundërshtim me pikën 3 i nenit 67 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020.

Neni 37

“Përditësimi nga institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore

1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Procedura e përditësimit mbështetet në:

a) verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së;

b) verifikimin e gjendjes juridike të pronës .Institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administron, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj.

3. Në përfundim të këtyre verifikimeve, institucioni administrues ose njësia e vetëqeverisjes vendore i paraqet për shqyrtim ASHK-së listën e pronave shtetërore të përditësuar, pjesë e detyrueshme e së cilës është dokumentacioni hartografik”.

Konkluzion:

-Bashkia Poliçan (Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve) nuk ka përgatitur dokumentacionin tekniko-ligjorë për 2294 pasuri, (pronave publike), evidentimin e pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop), si dhe hartimin e hartave kadastrale (plan rilevimet për çdo pronë) për të bërë të mundur transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore, mbështetur në pikën 3 të nenit 67 ligjit 111/2018 “Për Kadastrën” dhe në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, dhe në zbatim të VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

-Bashkia Poliçan (Sektori i Financës) nuk ka parashikuar dhe përllogaritur në buxhet kostot e nevojshme për kryerjen e plan rilevimeve për 2294 pasuri pronë publike si dhe aplikimet për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat dhe Skrapar, për regjistrimin e pronave të paluajtshme në pronësi ose në përdorim në emër të Bashkisë Poliçan, me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin e kësaj Bashkie dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në kundërshtim me pikën 1.2/a të nenit 9 dhe me pikën 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për veprime në kundërshtim me pikën 1.2/a të nenit 9 dhe me pikën 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. B.K, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Aseteve.

2. Znj. D.Z, me detyrë ish-Drejtor Drejtorie Juridike.

Në 2 raste kemi kalim pronësie për objekte të veçanta në Bashkinë Poliçan, konkretisht:

-Në lidhje me VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 “Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit social shtetërorë të ndërtesës së ish-Spitali, Poliçan”, rezultojë se nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me Urdhër nr. 186, datë 22.6.2016 është urdhëruar që të ngrihet grupi i punës për ndjekjen e procedurave dhe marrjen në dorëzim të ndërtesës, fondeve, pajisjeve, inventarin personelin dhe gjithë dokumentacionin përkatës sipas VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016.

-Në lidhje me VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”, me vendodhje në Poliçan, rezultojë se nga Kryetari i Bashkisë Poliçan me Urdhër nr. 218, datë 08.7.2018 është urdhëruar që të ngrihet grupi i punës për zbatimin e menjëhershëm të VKM-në 402, datë 04.7.2018, në vijim të urdhrit është lënë si detyrë drejtorive përkatëse që të kryen të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në pronësi të bashkisë Poliçan pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Skrapar, referuar aktit të marrjes në dorëzim të objekteve dhe truallit funksional brenda territorit të pronës nr. 1969 me emërtimin “Kombinati Mekanik Zona B”, me ve ndodhje në Poliçan, së bashku me plan vendosjen e objekteve dhe truallit funksional të tyre.

Nga auditimi rezulton se, për pasuritë të kaluara me VKM është aplikuar pranë ish-ZRPP-së Skrapar për regjistrim, dhe me datë 23.07.2018 është pajisur me certifikatë pronësie për sip.87,600 m² në llojin e pasurisë “Truall ndërtese” bazuar në VKM-në nr. 402, datë 04.7.2018 “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Poliçan, të pronës nr. 1069, me emërtim “Kombinati Mekanik Zona B”.

Me datë 31.01.2019 është pajisur me certifikatë pronësie për sip.3110 m² në llojin e pasurisë “Truall ndërtese” bazuar në VKM-në nr. 451, datë 15.06.2016 “Për kalimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të Qendrës Polivalente për Shërbime të për kujdesit Shoqërore.

Gjithashtu nga auditimi rezulton se, në Bashkinë Poliçan, në strukturën aktuale organizative nuk ka Drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen Përgjegjës i Menaxhimit Financiar dhe e Aseteve dhe Sektori Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

4.1/b. Regjistrimi i pronave të paluajtshme publike në emër të Bashkisë Poliçan, në DV ASHK Berat dhe Skrapar.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga 1582 pasuri që janë në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim, brenda juridiksionit të Bashkisë Poliçan, janë regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat vetëm 10 pasuri, konkretisht:

Nr.	Lloji i Pronës	Z.K.	Nr. Pasurisë	Sipërfaqja e Pronës M2	Vendndodhja e Pronës	Lëshimit i dokumentit të Pronësisë nga ASHK, data	Përfitimi i pronës
1	Kullote	3584	974/2	626252	Terpan	18.07.2023	Me VKM

2	Kullote	3584	974/3	240090	Terpan	18.07.2023	-II-
3	Kullote	3584	958/1	1011091	Terpan	31.07.2023	-II-
4	Kullote	3619	1378/1	353510	Tozhar	18.07.2023	-II-
5	Kullote	3619	1378/2	1112904	Tozhar	18.07.2023	-II-
6	Kullote	3572	1888	222668	Terpan	31.07.2023	-II-
7	Kullote	3572	1889	2168039	Teman	31.07.2023	-II-
8	Kullote	3572	1890	6400	Teman	18.07.2023	-II-
9	Kullote	3572	1890/2	651603	Teman	18.07.2023	-II-
10	Kullote	3584	957/1	417082	Terpan	31.07.2023	-II-

Burimi: Bashkia Poliçan

-Lidhur me sa sipër edhe pse ka kaluar mbi 4 vjet nga dalja e ligjit, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa për verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara përgatitja e dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentet e pronësisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” datë 05.03.2020.

Neni 37

“Përditësimi nga institucioni administrues ose njësi e vetëqeverisjes vendore

1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Konkluzion: Në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1623 pasuri të transferuar në pronësi ose në përdorim të miratuar me VKM, nga këto të regjistruar në regjistrat kadastral (DV ASHK Berat dhe Skrapar) dhe pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan janë 48 pasuri, ndërsa 1575 pasuri vijnë të pa regjistruar, që do të thotë që për këto pasuri të pa regjistruar nga Bashkia Poliçan nuk është përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për regjistrim dhe pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK Berat dhe Skrapar, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.Sh.”.

4.1/c. Krijimi i regjistrit kontabël të pronave publike që ka në administrim Bashkia Poliçan.

Bashkisë Poliçan së bashku me Njësinë Administrative Tërpan i kanë kaluar në pronësi gjithsej 1623 prona me VKM, të cilat nuk janë pajisur me dokumentin e pronësisë të regjistruar në ish-ZVRPP-në Berat dhe Skrapar sot DV ASHK, ku procedura e pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK shoqërohet edhe me vlerësimin e secilit objekt, vlerë e cila pas regjistrimit në ASHK regjistrohet në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtime e konstruksione”. Pra këto objekte duke mos patur një vlerë kontabël, nuk janë pasqyruar në kontabilitet në llogaritë e tyre përkatëse të mësipërme. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik ku citohet:

26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

27. Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit. 28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë.

30. Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

31. Njësia publike e qeverisjes së përgjithshme duhet të mbajë një regjistër të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës.

Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8743/2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar dhe në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, Regjistri i aktiveve të njësisë të sektorit publik.

1. Znj. B.K, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Aseteve.
2. Znj. D.Z, me detyrë ish-Drejtor Drejtorie Juridike.

IV. REKOMANDIME

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit rezultoi se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 96.1%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 230-231 “Kapitale të Patrupëzuara/Kapitale të Trupëzuara”, duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë Transfertat Korrente të Brendshme. Vihet re se për vitin 2023 art. (604) transfertat korrente të brendshme paraqiten 70.5 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët. Përsa i përket vlerës së mbuluar nga të ardhurat e veta + Granti është 71,945 mijë lekë ose në masën 28.5 %, dhe Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti është 680,565 lekë ose në masën 71 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave ku vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta është në vlerën 64,183 mijë lekë ose 6.6% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku për investimet nga të ardhurat e veta janë mbuluar në vlerën 13,883 mijë lekë . Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, , UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, Udhëzimit MFE nr. 22, datë 30.07.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 15-16 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të

veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve, e për pasojë dhe të investimeve publike, me qëllim që të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të rishpërndahen dhe detajohen fondet, brenda afateve dhe sipas hierarkisë që përcakton kuadri ligjor e rregullator në fuqi.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Duke analizuar të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Finances dhe Buxhetit lidhur me detyrimet e prapambetura konstatohet se, detyrimi në fillim të vitit 2023, i mbartur nga viti 2022, ka qenë në vlerën 40,255,202 lekë, dhe detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 është në vlerën 5,860,090 lekë, me rezultat në total në fund të vitit 2023 në vlerën 26,997,423 lekë pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit. Nga auditimi konstatohet se, në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, nuk janë marrë masat për të mbuluar më parë detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim, Bashkia Poliçan ka paraqitur në MFE detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 në 26,997,423 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 283 prot., datë 30.01.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 9.93 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Poliçan në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare. Si rrjedhojë e situatës së krijuar këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 101. Udhëzimin nr.9, date 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Poliçan dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, me qëllim sigurimin në vijimësi të financimit të shërbimeve për qytetarët.

Përgjatë vitit buxhetor 2025 dhe në vijim

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Skrapar, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2023, ky afat nuk është respektuar në 5 (pesë) raste për vlerën 5,860,088 lekë ku si burim financimi i tyre kanë qenë nga të ardhurat e veta vlera 2,254,455 lekë dhe nga transfertat e pakushtëzuar vlera 3,605,635 lekë. Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, është shkaktuar për mungesë likuiditetesh, dhe mosrealizim të ardhurash. Kjo situatë përbën risk të shtuar për aplikimin e penalteteve nga ana e operatorëve për të cilët do të kryhet pagesa. Këto veprime janë në kundërshtim me Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Përgjatë vitit buxhetor 2025 dhe në vijim

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore në Bashkinë Poliçan për vitin 2023 janë realizuar në masën 63.6 %, nga 86,482,673 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 135,774,546 lekë.

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është planifikuar në vlerën 2,000,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 1,696,605 ose në masën 84.8 %;

-Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është planifikuar në vlerën 867,3000 lekë dhe është realizuar në 427,8144 lekë ose në masën 49.3 %;

-Taksa e tabelës është planifikuar në vlerën 19,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 18,600 lekë ose në masën 98 %;

- Tarifa veterinare të bagëtimeve të therura është planifikuar në vlerën 384,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 53,000 lekë ose në masën 13.8 %.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme. Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifate vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizoje situatën e mosrealizimeve, mangesite në planifikim, duke nxjerrë përgjegjesitë përkatëse, Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifate vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifate vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të Bashkisë, duke i ndarë dhe në tregues të veçantë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen regjistrim manual të çdo informacioni që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Poliçan dhe i administron në programin “Excel”, në mungesë të një sistemi elektronik të mirëfillt për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Nga ana e Sektorit të Tatim-Taksave, të dhënat janë në regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve

me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi elektronik të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Drejtorisë së të ardhurave, duke rrezikuar të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave dhe editime të tabelave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin “Excel” paraqet një risk të lartë me pasojë humbjen e të dhënave të tatimpaguesve dhe/ose përlllogaritje të gabuara të detyrimeve, penalteteve dhe kamatëvonesave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 22-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan të marrë masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë, në përputhje me formën dhe kodifikimin e përcaktuar në Udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.

Brenda një muaji nga dergimi i Raportit përfundimtar të auditimit.

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se nuk janë mbajtur akt-rakordimet çdo muaj me agjentët tatimorë. Të ardhurat nga ASHK-ja nuk derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Poliçan (*brenda datës 5 të çdo muaji*). Lidhur me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi.

Gjithashtu rakordimi nuk është mbajtur dhe me DRSHTRR Berat në lidhje me detyrimet tatimore të mjeteve që ka në përdorim kjo njësi vendore. Bashkia Poliçan nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Poliçan, nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj gjithashtu nuk ka filluar procedurat për gjatitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 117 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Kryetari i bashkisë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Poliçan, të marrë masa për krijimin e bazës së të dhënave për tatimet dhe taksat që mbliidhen sipas agjentëve tatimorë, të shqyrtojë informacione dhe nga institucione të tjera, të kryejë rakordime mujore të rregullta, si dhe për evidentimin e për diferencat e pa mbledhura nga ana e tyre, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj, të fillojë procedurat për penalizmin e agjentëve tatimorë.

Përgjatë vitit buxhetor 2025 dhe në vijim

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Bashkia Poliçan lidhur me gjendjen e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik/familjarë, ku në fund të vitit 2022 rezultojnë debitorë në vlerën 74,697,760 lekë, ndërsa detyrim i krijuar gjatë vitit 2023 është në vlerën 5,819,971 lekë. Në fund të vitit 2023 mbetet vlere debitorë progresive është 80,517,731 lekë. Pjesa me e madhe e detyrimit ka ardhur si pasojë e mos likuidimit të detyrimit nga subjekti “Kombinati Mekanik Poliçan” subjekt i cili është debitorë për vlerën 20,163,230 lekë ose në masën 67 % ndaj totalit të detyrimit nga subjektet “Fizik /Juridik” dhe 25 % të totalit të debitorëve

deri me 31.12.2023. Detyrimi tatimor në Bashkinë Poliçan më 31.12.2023 është në vlerën 80,517,731 lekë, vlerë kjo e kontabilizuar, cila përbëhet konkretisht nga:

- Debitorë Biznesi në vlerën 29,916,189 lekë për 85 subjekte.

- Debitorë për taksa dhe tarifa vendore për abonentët familjarë në vlerën 3,153,019 lekë për 952 abonentë.

- Debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 47,448,523 lekë për 2357 subjekte.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 23-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave vendore të marri masat përkatëse duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të taksave në vlerën **80,517,731** lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se në fund të vitit 2022 vlera debitorë nga mos pagesa e taksasës së ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 697,435 lekë, e cila i përket 21 abonentëve. Gjatë vitit 2023, janë faturuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë 21 abonentë me vlerë fature 632,577 lekë, nga ky detyrim është likujduar vlera 551,908 lekë cila i përket 14 abonentëve. Debitorë të krijuar gjatë vitit 2023 janë 7 debitorë për vlerën 80,669 lekë. Debitorë progresivë për taksën e ndikimit në infrastrukturë janë 28 abonentë me vlerë detyrimi 778,015 lekë detyrim i cili është i pa kontabilizuar dhe përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Poliçan. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore Bashkia Poliçan, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave Bashkia Poliçan, dhe agjentit tatimor përcaktuar në paketën fiskale VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022 ku përcaktohet se për kategorinë IV “Për ndërtesat në proces Legalizimi”, agjent tatimor është ALUIZNI Berat. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”. VKB nr.54 prot., datë 23.12.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekoamndimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me sektorin e të Ardhurave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **778,015 lekë**.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në 3 raste është dhënë me qira fondi pyjor, kullosor nëpërmjet ankandit publik, një sipërfaqe totale prej 464.975 ha ”Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë“, ku vlera e investimit në total është rreth 168,073,274 euro. Nisur nga kapitali që këto shoqëri kanë të regjistruar në QKB rezulton se këto shoqëri nuk kanë të bashkëlidhur dhe të pasqyruar burimet financiare për të investuar për shumën e deklaruar, që do të thotë se mungon një deklaratë nga Operatorët Ekonomik (OE) mbi dëshminë financiare të besueshme për mbulimin dhe përballimin e investimit të

projektit. Kriteri i kërkuar nga Njësia e Ankandit për garancinë financiare të mjaftueshme për përbalimin e investimit të parashikuar në plan-biznes, nuk është zbatuar nga OE pjesëmarrëse në ankand, dhe nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa e plotësuar kriterin e vendosur nga njësia e ankandit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 28-36 të Projekt Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën lidhur me dhënien e me qira, fondi pyjor, kullor, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të forcojë monitorimin gjatë zbatimit të kontratave, si dhe të marrë masat e nevojshme për parandalimin e shfaqjes së rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se llogaria 202 “Studime dhe kërkime” paraqitet në vlerën 2,704,895 lekë, e cila përfshin bashkimin e bilanceve me ish/Komunën Vërtop në vitin 2015. Për këto aktive nuk ka inventar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve dhe viti i krijimit të tyre. Kjo situatë është e mbartur që nga viti 2015 nga ndarja e re administrative dhe bashkimi i ish/komunës Vërtop me bashkinë Poliçan. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 26 dhe 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa për verifikimin e çdo zëri të llogarisë nr.202 “Studime dhe Kërkime” dhe pas evidentimit të projekteve të finalizuara dhe statusit të çdo zëri, të kryhen regjistrimet kontabël në lidhje me kapitalizimet në aktivet përkatëse apo çregjistrimet sipas rastit.

Në mbylljen e Bilancit kontabël 2024

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i analizës së llogarisë nr.218 “Inventar Ekonomik” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 43,429,912 lekë kosto historike. Nga shqyrtimi i analizës së kësaj llogarie rezulton se: është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera prej 5,742,796 lekë duke e mbivlerësuar këtë llogari për 19 aktive, të cilat sipas klasifikimit kontabël 17 prej tyre i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 2 (dy) aktive i përkasin llogarisë nr.212 “Ndërtime konstruksione”, duke sjellë një deformim të informacionit kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 8, datë 9.03.2018, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe e Tatim-Taksave në Bashkinë Poliçan të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2024, për sistemimin e vlerës prej 4,213,420 lekë në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për 17 aktive dhe dy aktive në llogarinë përkatëse 212 “Ndërtime e konstruksione” në vlerë 1,438,680 lekë, duke përllogaritur dhe normën e amortizimit.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 42,935,296 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 24 objekte. Nga këto objekte, për 14 prej tyre vlera e ngurtësuar e garancisë së punimeve në vlerën 1,732,975 lekë dhe pse afati i garancisë ka përfunduar në vitin 2020, nga Bashkia Poliçan nuk janë marrë masa

për xhirimin e fondeve te kontraktori, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 52-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Poliçan të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar çdo muaj vlerat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së procedurave dhe dokumentimit të procesit të inventarizimit të pasurisë së Bashkisë Poliçan u konstatua se, në asnjë rast Nëpunësi Zbatues i njësisë nuk ka qenë kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 99. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Në procesin e inventarizimit i cili do kryhet gjatë vitit 2024, nëpunësi zbatues i njësisë duhet të përcaktohet si kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve, kjo pasi ka njohuritë e duhura në fushën e menaxhimit financiar. Po ashtu duke qenë se njeh dhe disponon çdo veprim financiar të njësisë vendore Bashkia Poliçan.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në juridiksionin e Bashkinë Poliçan janë gjithsej 1623 pasuri të transferuar në pronësi të miratuar me VKM, nga këto të pajisur me dokument pronësie në emër të Bashkisë Poliçan janë vetëm 53 pasuri, ndërsa për 1570 pasuri nuk është aplikuar. Bashkia Poliçan nuk ka përgatitur dokumentacioni hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokument pronësie, që do të thotë se nuk është aplikuar për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit 20/20 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 55-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Bashkia Poliçan të aplikoj për pajisje me certifikatë pronësie pranë DV ASHK (Berat dhe Skrapar) për pasuri që kanë prioritet në investime dhe në ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, ku pas pajisjes me certifikatë pronësie nga ASHK-ja këto pasuri të regjistrohesh në regjistrin e aktiveve afatgjata të bashkisë me vlerën e saj kontabël si dhe të kontabilizohet në pasqyrat financiare në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Poliçan (Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Administrimit të Pyjeve) nuk është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjorë për 2294 pasuri, (prona) publike, për evidentimin e pasurive për çdo zonë kadastrale pranë NJA Vërtop si dhe përgatitja e hartave kadastrale (plan rievimet për çdo pronë) për të bërë të mundur transferimin e pronave të paluajshme shtetërore, mbështetur në pikën 3 të nenit 67 ligjit 111/2018

“Për Kadastrën”, të nenit 22 të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjë hapësinor në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të kryehut III pika 12 i VKM-së nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 55-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Bashkia Poliçan të marr masa për hartimin e planeve të rievimit, verifikimin e gjendjes faktike në terren, me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik dhe dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për të bërë të mundur transferimin e 2294 pasurive që janë brenda juridiksionit të Njësisë Administrative Vërtop, Bashkia Poliçan.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit nuk ka parashikuar dhe përllogaritur në buxhet kostot e nevojshme për pagesa e tarifës për përgatitjen e plan rievimit për pasurit pronë publike që do të dorëzohen pranë DV ASHK, për të bërë të mundur transferimin në pronësi të bashkisë Poliçan me qëllimin e hapjes rrugë për zhvillim në shumë aspekte në territorin e kësaj Bashkie përcaktuar në prioritetet e investimeve dhe ushtrimin e të drejtave të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, veprime këto në zbatim të pikës 1.2/a të nenit 9 dhe me pikën 5 të nenit 27, të Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 55-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Bashkia Poliçan (Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit) të parashikoj dhe të përllogarisë në buxhetin e ardhshëm kostot e nevojshme për përgatitjen e plan rievimit për të gjithë pasuritë pronë publike që do të dorëzohen pranë DV ASHK, që kjo e fundit ti dërgoj për miratim në Këshillin e Ministrave.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Poliçan ka patur Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022 detyrim në vlerën 7,082,391 lekë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 2,652,382 lekë, vlerë e cila i përket vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim si objekt i vendimeve për çështje të tjera gjyqësore. Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 është në vlerën 4,430,009 lekë. Vlera totale **2,652,382 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023 nga Bashkia Poliçan, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, *konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.* Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, ku do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Mos kryerja e kësaj analize nga Titullari është në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 19-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Poliçan të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore.

Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave në Bashkinë Poliçan, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura nga zyra e prokurimeve dhe nga Sektori i të Ardhurave Vendore, Bashkia Poliçan, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Poliçan të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike. Nga të dhënat rezultoi se në territorin e Bashkisë Poliçan, kanë kryer punime ndërtimi kryesisht rkonstruksione 5 subjekte, të cilët janë me adresë sekondare. Nga auditimi konstatohet se, është faturuar vlera prej 190,240 lekë për të cilën nuk janë kryer arkëtime për këtë detyrim, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Poliçan. Gjithashtu konstatohet se, nga kryqëzimi i informacionit me drejtorinë e financës vlera debitore e cituar më lart nuk është regjistruar në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Shkronjën “a” e pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Poliçan të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **190,240 lekë**, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, nga Drejtoria e Tatim-Taksave nuk është përlogaritur kamatë vonesa prej 2 ditësh, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” shpk, duke shkaktuar të ardhura të munguara në shumën prej 211,200 lekë, në kundërshtim me nenin 5.2. të kontratës së qirasë “Pagesa e Qirasë”. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim-Taksave të njoftojë qiramarrësin shoqërinë “X” shpk i përfaqësuar nga administratori z. Ç.I, për likuidimin e shumën prej **211,200** lekë, shuma e cila ka lidhje me mos përlogaritjen e kamatë vonesës prej 0,01 % në ditë, në lidhje me kontratën e lidhur në datë 30.08.2023 me qiradhënës Bashkia Poliçan dhe qiramarrës subjektin “X” shpk.

Brenda 3 mujorit të parë 2025

D. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, dhe kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandoj**

Kryetarin të Bashkisë Poliçan të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “**Vërejtje**”, për **11** (trembëdhjetë) punonjësit, si më poshtë:

1. Znj. O.N, me detyrë Ing. në cilësinë e Kryetarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

2. Znj. K.R, me detyrë Ekonomiste, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

3. Z. H.N, me detyrë Agronom, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

4. Znj. D.Z, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

5. Z. A.Sh, me detyrë Agronom, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

6. Znj. I.G, me detyrë Ing. në cilësinë e Kryetarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

7. Znj. A.C, me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore , në cilësinë e anëtarit të KVO.

Në lidhje me 3 rastet e konstatuara për dhënien me qira nga Bashkia Poliçan të fondin pyjor, kullor nëpërmjet ankandit publik, “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”, ku nga KVO janë kualifikuar operatorët ekonomik (OE) pa u plotësuar kriteri i vendosur nga njësia e ankandit.

Për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

8. Znj. F.H, Drejtor i Financës dhe Buxhetit, për veprime në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kapitulli II, pikat nr.29, 30, 39 dhe 50, si dhe në kundërshtim me UKM nr.3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kapitulli II, pika nr.10.

9.Z. Ç.K, specialist në Drejtorinë e Tatim-Taksave, nga mosveprimet janë shkaktuar të ardhura të munguara në shumën prej 211,200 lekë, në kundërshtim me nenin 5.2. të kontratës së qirasë “Pagesa e Qirasë”.

10. Znj.S.Q, specialiste e tatimit detyrimeve fiskale dhe mbledhjes së taksës së tokës bujqësore në njësinë Terpan, mos marrja e masave për taksën e tokës bujqësore ku rezulton në vlerën 47,448,523 lekë ose 93.7 % të totalit të “debitorëve nga familiarët, dhe 58.9 të “totalit të debitorëve” veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

11. Z. K.K, specialist i tatim taksave në Njësia Vërtop, Për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93, 94.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore në pikat “E” dhe “F” më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë: 1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit për punonjësit e listuar në pikën “E”, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar. 2. Ti kërkojë Departamentit të Administratës Publike kryerjen e verifikimeve nëse punonjësit e listuar në pikën “F” janë pjesë e shërbimit civil dhe të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procedurës disiplinore, mbi bazën e fakteve të paraqitura në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. 3. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHËRBIMIT